



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 557 Akti

Nr. 652 Vendimi  
Tiranë, më 28.4.2023

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 26.4.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Armand Gurakuqi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi, me

detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 26.4.2023 kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.6.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo), pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në datën 21.7.2020 është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike të datës 22.7.2020 konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.
6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Armand Gurakuqi, me vendimin nr. 2, datë 11.4.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit

4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

7. Në datën 18.4.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 24.4.2023.
8. Subjekti i rivlerësimit u paraqit pranë Komisionit për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik dhe në formë elektronike, të cilat iu vunë në dispozicion së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht.
9. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike në datën 24.4.2023, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 24.4.2023, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 26.4.2023, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.4.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.
11. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Armand Gurakuqi parashitroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 26.4.2023 u mbyll për të rifilluar më 28.4.2023 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

12. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

### A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
  - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
  - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
15. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
16. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

#### 1. Apartament banimi me sipërfaqe 92 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë

1. Subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi, në deklaratën vetting, si burim për krijimin e kësaj pasurie, me vlerë 40.500 euro, ka deklaruar: (i) 20.500 euro nga të ardhurat dhe kursimet familjare; dhe (ii) 20.000 euro nga kontrata e kredisë me nr. \*\*\*, datë 20.9.2007.
2. Gjithashtu subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005<sup>1</sup> lidhjen e një kontrate premtim-shitje banese me shtetasin F. Sh., por nuk ka përcaktuar vlerën e banesës, kryerjen e ndonjë pagese apo të ndonjë detyrimi të mbetur. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: “Kontratë premtim-shitjeje e muajit maj 2005 për blerjen e një apartamenti me vlerë 40.500 euro”. Më pas, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Kontratë premtim-shitjeje nr. \*\*\*, datë 13.7.2005, lidhur me shoqërinë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., për porositjen e apartamentit në vlerën 40.500 euro”.
3. Në kontratën premtim-shitje<sup>2</sup> me të dhënat e cituara më sipër ishte përcaktuar se pagesa do të bëhej me 3 këste. Konkretisht: (i) shuma 20.480 euro do të paguhej në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) shuma 16.000 euro do të paguhej me marrjen në dorëzim të apartamentit; (iii) shuma 4.000 euro do të paguhej me nënshkrimin e kontratës së shitjes dhe regjistrimin e apartamentit në emër të blerësit.
4. Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 31.5.2005, në të cilën

<sup>1</sup> Në rubrikën e të dhënave konfidenciale.

<sup>2</sup> E cila gjendet bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

shoqëria shitëse ka deklaruar se ka marrë nga subjekti i rivlerësimit shumën 20.000 euro, si këst të parë për shitjen e apartamentit në analizë.

5. Nga ASHK<sup>3</sup> Tirana Veri, por edhe nga verifikimi i kryer nga Komisioni *online* në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, është konfirmuar se apartamenti në fjalë, me nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, i regjistruar në emër të z. Armand Gurakuqi dhe znj. G. G., si pasuri e përfutur me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*\*<sup>4</sup>, datë 29.12.2017, nga shitësi F. Sh.
6. Nëpërmjet pyetësorit nr. 7, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegonte arsyet e shitjes së kësaj pasurie nga z. Sh., ndërkohë që kontrata e premtim-shitjes ishte lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti është shprehur se shtetasi F. Sh. ka qenë administrator dhe ortak me 100% të kapitalit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Kjo shoqëri ka qenë pronare e një sipërfaqe trualli prej 9.357 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, mbi të cilën është ndërtuar edhe objekti ku ndodhet apartamenti në analizë. Me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 2.6.2005, është dakordësuar që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., si pronare e truallit, do t’i vinte në dispozicion ½ e sipërfaqes së truallit të mësipërm shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. si sipërmarrëse, për ndërtimin e një objekti, i cili do të kryhej sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga KKRRT-ja. Në përfundim të ndërtimit, shoqëria investuese do t’i jepte shoqërisë pronare të truallit 22% të sipërfaqes ndërtimore.
7. Me anë të kontratave nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* të datës 3.10.2006, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i ka shitur z. F. Sh. një pjesë të sipërfaqes së truallit prej 9.357 m<sup>2</sup>, për të cilën ishte miratuar leja e ndërtimit. Në vijim, z. Sh., në cilësinë e pronarit të truallit, ka nënshkruar kontratën e shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 22.7.2014, me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., nëpërmjet së cilës ka kaluar në pronësi të z. Sh. sipërfaqja ndërtimore takuese, e përbërë nga një njësi dhe 12 apartamente, ku përfshihet edhe apartamenti nr. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, i porositur më herët nga subjekti i rivlerësimit.
8. Lidhur me regjistrimin e pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit, 2 vjet pas regjistrimit fillestar të saj në emër të palës shitëse, ndonëse u pyet në pyetësorin nr. 7 lidhur me këtë konstatim, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion që të provonte njoftimin e tij nga pala shitëse për regjistrimin e pasurisë. Subjekti ka deklaruar se gjatë këtyre viteve ai ka jetuar në apartamentin që kishte në pronësi së bashku me familjen, në rrugën “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, Tiranë.
9. I pyetur në lidhje me rivlerësimin e apartamentit në analizë, subjekti ka deklaruar se rivlerësimi është bërë në datën 25.11.2016, në vlerën 6.900.000 lekë, nga z. Sh., pasi vetë ai nuk ishte bërë ende pronar i apartamentit në atë kohë. Subjekti ka sqaruar se procedura e rivlerësimit mund të realizohej vetëm nga pronari<sup>5</sup>, që në atë kohë ishte z. Sh. dhe kjo ka qenë arsyeja e mosdeklarimit të rivlerësimit nga ana e tij.

---

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020.

<sup>4</sup> Lidhur mes subjektit e bashkëshortes së tij në cilësinë e palës blerëse dhe z. F. Sh. e bashkëshortes së tij në cilësinë e palës shitëse, kundrejt çmimit 40.480 euro, likuiduar sipas kontratës së premtim-shitjes së vitit 2005.

<sup>5</sup> Në nenin 1 të ligjit nr. 81/2016, datë 25.7.2016, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, parashikohet: “*Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 28 shkurt 2017 të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut*”.

10. UKT-ja<sup>6</sup> konfirmoi një kontratë në emër të subjektit, e cila përputhet me atë të deklaruar nga vetë ai<sup>7</sup>, ndërsa FSHU-ja<sup>8</sup> konfirmoi dy kontrata në emër të subjektit, çka ka rezultuar e provuar edhe nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.
11. Referuar udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit ‘k’ për vitin 2005”, çmimi mesatar i shitjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2005, ka qenë 77.452 lekë/m<sup>2</sup>, çka do të rezultonte në një çmim për apartamentin e porositur nga subjekti, rreth 7.122.500 lekë në krahasim me çmimin e aplikuar prej rreth 4.960.500 lekësh.
12. I pyetur në lidhje me diferencën e rezultuar, në përgjigjet e pyetësorit nr. 7, subjekti është shprehur se në përcaktimin e çmimit të shitjes, në vitin 2005, për apartamentin e mësipërm kanë ndikuar edhe disa rrethana të tjera, si fakti që kontrata dhe pagesa e kryer në vitin 2005 janë realizuar në një kohë që objekti nuk kishte filluar ende të ndërtohej, ashtu edhe fakti që z. Sh. kishte nevojë për një shumë parash në dispozicion, duke bërë që të aplikohesh çmimi<sup>9</sup> prej 440 - 450 euro/m<sup>2</sup>. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur disa kontrata të nënshkruara nga e njëjta palë shitëse, në të njëjtën periudhë e në të njëjtin objekt, ku ka rezultuar një çmim shitjeje pothuajse i njëjtë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë konflikt interesi me z. F. Sh. dhe as me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k<sup>10</sup>. Sa më sipër, është konfirmuar edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>11</sup>.
13. SPAK ka bërë me dije se shtetasi F. Sh. nuk ka rezultuar i proceduar apo i hetuar nga ky institucion.
14. Nisur nga sa është shpjeguar, por edhe nga dokumentacioni i disponuar nga institucionet, në raport me marrëdhënien miqësore për të cilën është pyetur, për aq kohë sa nuk u evidentua ndonjë rast ku subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar apo shqyrtuar çështje me palë të interesuar shtetasin F. Sh., Komisioni i vlerëson shpjegimet bindëse dhe shteruese, duke mos konstatuar ndonjë konflikt interesi.

### **1.1. Analizimi i burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

15. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar pagesat e kësteve për blerjen e apartamentit, vuri në dispozicion deklaratën noteriale të datës 31.5.2005, të palës shitëse F. Sh., mbi pagesën e kështit të parë të pasurisë në analizë. Referuar kësaj deklarate, si dhe nisur nga përgjigjet e subjektit në pyetësorin nr. 2, Komisioni ka konsideruar datën 31.5.2005 si datën e kryerjes së pagesës prej 20.000 euro (ekuivalenti i 2.450.800 lekë), me burim nga të ardhurat dhe kursimet e familjes. Në vijim, në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti është shprehur se edhe shuma prej 480 euro është paguar prej tij në vitin 2005. Ndërsa, për mobilimin e

---

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2022.

<sup>7</sup> Në emër të z. G. G. ka rezultuar kontrata me nr. \*\*\* për objektin me adresë në rrugën “\*\*\*\*”.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2020.

<sup>9</sup> Me të njëjtin çmim 440 euro/m<sup>2</sup>, z. Sh. ka shitur apartamentin me kontratën nr. \*\*\*, datë 21.7.2005. Ndërsa me çmimin 450 euro/m<sup>2</sup> z. Sh. ka shitur apartamentin me kontratën nr. \*\*\*, datë 13.10.2005 dhe kontratën nr. \*\*\*, datë 1.9.2005.

<sup>10</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022.

apartamentit të tij, subjekti ka deklaruar<sup>12</sup> shpenzime të kryera në vitet 2006 dhe 2007 në vlerën rreth 300.000 lekë.

16. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij ka rezultuar se gjatë muajit maj 2005 prej tij janë kryer tërheqje<sup>13</sup> nga depozitat bankare, konkretisht: (i) 7.826,74 euro në datën 31.5.2005; (ii) 423.431 lekë në datën 24.5.2005; dhe (iii) 1.095 euro në datën 31.5.2005, të cilat duket se mund të jenë përdorur për kryerjen e pagesës së kështit të parë të apartamentit, për të cilën është deklaruar burimi, në deklaratën *Vetting*, nga kursimet familjare.
17. Ndërkohë, nga shqyrtimi i historikut të këtyre depozitave bankare, por edhe të deklaratave periodike të dorëzuara nga subjekti deri në vitin 2005, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumat, si në vijim: (i) 400 euro në datën 7.5.2002; (ii) 800 euro në datën 13.9.2002; (iii) 3.000 euro në datën 28.8.2003; (iv) 400.000 lekë në datën 17.2.2004; dhe (v) 4.700 euro në datën 17.8.2004.
18. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar fillimisht në DIPP-në e vitit 2003 se ka një shumë prej 400.000 lekësh *cash* (të depozituara më tej në shkurt të vitit 2014 në NBG Bank), për të cilat ka deklaruar burimin nga paga personale, pensioni i nënës, të ardhura familjare nga vëllai emigrant në Greqi dhe motra emigrante në SHBA. Në DIPP-në e vitit 2003, ai ka deklaruar gjithashtu një depozitë në NBG Bank prej 4.000 euro, për të cilat nuk ka deklaruar burimin dhe që nga Komisioni është konsideruar me të ardhurat e vetë subjektit dhe familjes së tij, të përbërë në atë kohë nga nëna dhe motra K. G.
19. Më tej, në DIPP-në e vitit 2004, ai ka deklaruar depozitën prej 400.000 lekësh të çelur në shkurt të vitit 2004 (e deklaruar më herët në vitin 2003), një depozitë të re në shumën 4.700 euro të dhuruar nga vëllai emigrant në Greqi, si dhe 400.000 lekë *cash*, gjithashtu me burim nga vëllai emigrant në Greqi.
20. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, ai nuk i ka ruajtur dokumentet që vërtetojnë dërgimin nëpërmjet Western Union të shumave monetare të dhuruara nga motra në SHBA dhe vëllai në Greqi. Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2022, të lëshuar nga Unioni Financiar Tiranë, ku është cituar se të dhënat mbahen për një periudhë 5-vjeçare dhe më pas fshihen nga sistemi kompjuterik. Po ashtu, në këtë dokument, janë listuar 4 transferta në mbërritje për subjektin e rivlerësimit, dërguar nga motra e tij nga SHBA-ja, gjatë periudhës 2018 – 2022.
21. Subjekti ka paraqitur gjithashtu deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 11.6.2021, të lëshuar nga motra e tij, e cila ka deklaruar se nga viti 2000 e në vijim ka dërguar shuma të ndryshme monetare, rreth 1.500 – 2.000 USD/vit, në formën e ndihmës për nënën. Po ashtu, ai ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 15.10.2022, të lëshuar nga vëllai i tij, i cili ka deklaruar se në vitet 2003, 2004 dhe 2009 ka dërguar para në favor të subjektit të rivlerësimit, për nevoja familjare, përkatësisht shumat 4.000 euro në vitin 2003, 4.700 euro dhe 400.000 lekë në vitin 2004.

---

<sup>12</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

<sup>13</sup> Në total, ekuivalenti i 1.516.701 lekëve.

22. Së bashku me deklaratimet e mësipërme, subjekti ka paraqitur dokumentacionin mbi të ardhurat e motrës dhe vëllait të tij, të përkthyer dhe të noterizuara, duke nisur nga viti 1998 e në vijim.
23. Në vijim, Komisioni ka përllogaritur mundësinë e subjektit për të depozituar shumat në vitet 2002 dhe 2003, në total 4.200 euro, me të ardhurat e tij dhe të nënës, si dhe shpenzimet për 3 persona (për sa kohë në përbërje familjare në atë kohë ka qenë dhe motra e subjektit), nga ku ka rezultuar si në vijim. Në këtë analizë nuk është përfshirë ndonjë shumë e dhuruar nga motra e subjektit në SHBA, pasi, me aq sa ka rezultuar nga dokumentacioni i përcjellë nga subjekti mbi të ardhurat e gjeneruara prej saj në SHBA, ato kanë rezultuar në një masë pothuajse të barabartë me shpenzimet e jetesës së një familjeje prej 4 personash në SHBA<sup>14</sup>, duke mos lejuar mundësinë e kursimit të ndonjë shume.

**Tabela nr. 1** – analiza e burimeve për depozitimin e shumës 4.200 euro në gusht 2003

Te ardhura te subjektit nga Magjistratura 2001 - 2002	468,710
Te ardhura te subjektit nga paga 2002 - gusht 2003	567,619
Te ardhura nga pensioni nenes 2001 - gusht 2003	214,861
Dhurata nga motra e subjektit ne SHBA	-
Shpenzime jetese 2001 - gusht 2003	(750,912)
Shpenzime qiraje janar - gusht 2003	(120,000)
Shpenzime arredimi	(100,000)
Depozituar deri ne gusht 2003	(562,756)
<b>Rezultati ne gusht 2003</b>	<b>(282,478)</b>

24. Për shumat në DIPP-në e vitit 2004, prej 4.700 euro dhe 400.000 lekësh, subjekti ka deklaruar burimin nga dhurimet prej të vëllait, me të ardhurat nga emigracioni. Ndërsa, shuma prej 400.000 lekësh, e cila në vitin 2003 ndodhej në gjendjen *cash* dhe që më tej është depozituar në NBG Bank në shkurt të vitit 2004, Komisioni ka konsideruar analizën sipas deklaratimit të subjektit, me të ardhurat familjare, duke përfshirë të ardhurat e subjektit, nënës së tij për një periudhë 4-mujore (pas depozitimit në gusht 2003) dhe të ardhurat e vëllait nga emigracioni në Greqi.
25. Nga sa më sipër, duket se pas depozitimit të shumës 4.200 euro në gusht të vitit 2003 e deri në fund të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë rezultuar me një balancë pozitive prej 90.641 lekësh.

**Tabela nr. 2** – analiza e mundësisë së kursimit të subjektit deri në fund të vitit 2003

Te ardhura te subjektit nga paga shtator - dhjetor 2003	214,883
Te ardhura nga pensioni nenes shtator - dhjetor 2003	29,622
Shpenzime jetese shtator - dhjetor 2003	(93,864)
Shpenzime qiraje shtator - dhjetor 2003	(60,000)
<b>Mundesesi kursimi deri ne fund 2003</b>	<b>90,641</b>

<sup>14</sup> <https://www2.census.gov/programs-surveys/cps/techdocs/cpsmar19.pdf>



26. Komisioni ka analizuar të ardhurat nga vëllai i subjektit nga emigracioni, për diferencën e shumës prej 400.000 lekësh (309.359 lekë, duke konsideruar se shuma prej 90.641 lekësh ishte kursyer nga vetë subjekti), nga ku ka rezultuar se ai mund t'i kursente ato me burime të ligjshme financiare. Gjithashtu, Komisioni ka analizuar edhe mundësinë e vëllait të subjektit për të dhënë shumat prej 400.000 lekësh dhe 4.700 euro deri në muajin gusht 2004, ku ka rezultuar se ai ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.

**Tabela nr. 3** – analiza e burimeve për shumat e dhuruara nga vëllai

Të ardhura nga emigracioni 1998 - 2003	5,539,229
Shpenzime jetese ne Greqi 1998 - 2003	(3,525,700)
Kursyer deri ne fund 2003	(309,359)
<b>Rezultati</b>	<b>1,704,170</b>
Të ardhura nga emigracioni janar - gusht 2004	343,659
Shpenzime jetese ne Greqi janar - gusht 2004	(219,320)
Dhuruar subjektit ne gusht 2004 (400.000 leke & 4.700 euro)	(995,678)
<b>Rezultati</b>	<b>832,831</b>

27. Komisioni ka përlogaritur mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të kryer pjesën e mbetur të këstit të parë, me burim nga të ardhurat dhe kursimet e familjes së tij. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2004 ka rezultuar deklarimi i kursimeve *cash* prej 400.000 lekësh në fund të atij viti. Ndërkohë, përgjatë një periudhe 5-mujore të vitit 2005, subjekti dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij kanë realizuar të ardhura<sup>15</sup> në masën ~ 401.225 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, subjekti është shprehur se bashkëshortja e tij gjatë periudhës 2000 – 2004, që ka punuar pranë Bashkisë P., ka ruajtur një pjesë të të ardhurave të saj<sup>16</sup> në formën e kursimeve *cash*, të cilat i ka përdorur më pas për një pjesë të këstit të parë të apartamentit. Duke qenë se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë lidhur martesë në vitin 2004, këto kursime *cash* të bashkëshortes duhet të ishin deklaruar prej tij në DIPP-në e atij viti. Për sa kohë kursimet e pretenduara nuk janë deklaruar prej tyre në vitin përkatës, Komisioni vlerëson se ato nuk mund të konsiderohen si një ndër burimet e përdorura për këtë pasuri.
28. Po ashtu, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka pretenduar se nëna e tij nuk i ka përdorur të ardhurat nga pensioni dhe shumat që i dërgonin fëmijët, duke krijuar kështu një vlerë monetare të kursyer, e cila nuk është deklaruar nga subjekti, për shkak se nëna nuk përfshihej në rrethin e personave të lidhur, por që në rastet kur paraqitej e nevojshme, ia vendoste në dispozicion me qëllim për të përmbushur nevojat familjare. Sa i përket këtij pretendimi, nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit ka rezultuar se ai ka deklaruar ndërkohë të ardhurat e nënës së tij nga pensioni në të ardhurat familjare e, për rrjedhojë, edhe në kursimet familjare. Për pasojë, ato nuk janë konsideruar nga Komisioni si një ndër burimet financiare të përdorura.

<sup>15</sup> Llogaritur këto në mënyrë përpjesëtimore, për sa kohë pagat gjatë atij viti nuk kanë qenë të gjitha të kanalizuarat nëpërmjet sistemit bankar.

<sup>16</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 12.10.2022, e lëshuar nga bashkëshortja e tij.

29. Në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 7, subjekti i rivlerësimit, me postën elektronike të datës 16.3.2022, ka përcjellë një aktekspertim, në të cilin është kryer analiza financiare për kryerjen e pagesës së këstit prej 20.000 euro në datën 31.5.2005. Në këtë analizë të paraqitur nga subjekti janë përfshirë edhe kursimet e bashkëshortes dhe të nënës së tij, sikurse kishte parashtruar më herët në përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Komisioni nuk i ka përfshirë këto në analizën e mëposhtme si pasojë e mosdeklarimit të tyre në DIPP-të e vitit 2005 apo ato të mëparshme të dorëzuara prej tij, siç është vlerësuar edhe më lart.
30. Pas përllogaritjes së shpenzimeve të familjes për një periudhë 5-mujore, me të dhënat e disponuara nga Komisioni, ka rezultuar se për kryerjen e pagesës së këstit të parë të apartamentit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -402.536 lekë.

**Tabela nr. 4** – analiza e burimeve për blerjen e apartamentit

Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2005 - 31.5.2005	338,854
Të ardhura nga paga e b/shortes 1.1.2005 - 31.5.2005	-
Të ardhura nga pensioni i nënës 1.1.2005 - 31.5.2005	46,378
Të ardhura nga interesat bankare	15,994
Tërhequr nga subjekti nga depozita bankare (me burim nga kursimet familjare dhe dhurimet e vëllait nga te ardhurat nga Greqia në vitet 2003 dhe 2004)	1,550,953
Kursime cash në fund të vitit 2004	400,000
Shpenzime jetese 4 persona (janar - maj 2005)	(182,595)
Shpenzime qiraje janar - maj 2005	(62,500)
Pagesë e këstit të parë të apartamentit	(2,509,619)
<b>Rezultati në datë 31.5.2005</b>	<b>(402,536)</b>

31. Komisioni ka përllogaritur gjithashtu mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të rikrijuar kursimet *cash* prej 400.000 lekësh deri në fund të vitit 2005 – për sa kohë ai nuk ka deklaruar ndryshime të këtyre kursimeve nga viti i mëparshëm – me burime të ligjshme financiare, nga ku ka rezultuar një mungesë prej -206.655 lekësh, sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr. 5** – analiza e burimeve për rikrijimin e kursimeve *cash*

Të ardhura nga paga e subjektit 1.6.2005 - 31.12.2005	474,395
Të ardhura nga paga e b/shortes 1.6.2005 - 31.12.2005	11,544
Të ardhura nga pensioni i nënës 1.6.2005 - 31.12.2005	64,929
Kursime cash rikrijuar deri në fund të vitit 2005	(400,000)
Shpenzime jetese 4 persona (qershor - dhjetor 2005)	(255,633)
Shpenzime qiraje qershor - dhjetor 2005	(87,500)
Rritje e likuiditeteve në llogarite bankare	(14,389)
<b>Rezultati në datë 31.12.2005</b>	<b>(206,655)</b>

32. Për kryerjen e pagesës së këstit të dytë, subjekti i rivlerësimit ka marrë një kredi bankare pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, me anë të kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë

20.9.2007, për shumën 20.000 euro, të cilat do të përdoreshin për blerjen e një apartamenti të ri. Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të kredisë, ajo është disbursuar në datën 26.9.2007 dhe po në këtë datë është transferuar në favor të palës shitëse, z. F. Sh., konfirmuar kjo edhe nga “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>17</sup>. Për sigurimin e kësaj kredie, z. Sh. ka vendosur si garanci hipotekore një apartament në bashkëpronësi të tij, me anë të kontratës së hipotekimit nr.\*\*\*, datë 20.9.2007, kjo pasi – për shkak të divorcit të prindërve të subjektit dhe ndërprerjes së marrëdhënieve me babain e tij – nuk mund të vendosnin si garanci shtëpinë në bashkëpronësi të prindërve të subjektit, në Elbasan.

33. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara, si dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit për këtë pasuri, si vijon:

- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhurimet e përfituara nga vëllai i tij, si një ndër burimet e përdorura për krijimin e pasurisë në fjalë.
- Duket se për krijimin e depozitës prej 4.200 euro, deri në muajin gusht 2003 – e të përdorur më tej për pagesën e këstit të parë të apartamentit në analizë – subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -282.478 lekësh.
- Duket se për kryerjen e pagesës së këstit të parë të blerjes së apartamentit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -402.536 lekësh.
- Duket se për rikrijimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë në fund të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -206.655 lekësh.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

34. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të dhurimeve të përfituara nga vëllai i tij, si një ndër burimet e pasurisë në analizë, subjekti është shprehur se: “...kam shpjeguar në mënyrë të përgjithshme burimin e parave të përdorura për pagesën e këstit të mësipërm, duke vlerësuar se nuk paraqitej i nevojshëm detajimi i të ardhurave dhe kursimeve. Në shprehjen ‘të ardhurat dhe kursimet familjare’ unë kam përgjithësuar të gjitha burimet e të ardhurave, si pagat e mia, pagat e bashkëshortes, dhuratat që vëllai dhe motra ime më kanë dhënë gjatë viteve, pensioni i nënës dhe kursimet që nëna kishte krijuar nga pensioni dhe ndihma ekonomike që i ishte siguruar nga vëllai im M. dhe motra ime M. Deklarimi me një terminologji përgjithësuese i burimit të të ardhurave është vlerësuar i mjaftueshëm nga ana ime e, rrjedhimisht, nuk kam përshkruar në mënyrë të detajuar të gjitha burimet e mësipërme...”.

35. Lidhur me krijimin e depozitës prej 4.200 euro, deri në muajin gusht 2003 – e të përdorur më tej për pagesën e këstit të parë të apartamentit në analizë – subjekti ka shpjeguar se në

---

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2022.

rubrikën “Burimi” të DIPP-së së vitit 2003, deklarimi “paga personale, pensioni i nënës, të ardhura familjare nga vëllai emigrant në Greqi dhe motra emigrante në SHBA” është paraqitur në mënyrë të përbashkët për të dyja shumat e përshkruara në rubrikën “Përshkrimi”, si për vlerën *cash* 400.000 lekë, ashtu edhe për depozitën prej 4.000 euro, duke vlerësuar se ka qenë i mjaftueshëm përshkrimi në mënyrë të përmbledhur i të gjitha burimeve të të ardhurave, pa qenë nevoja për të bërë një lidhje të veçantë mes burimit të të ardhurave dhe secilës prej vlerave të deklaruara. Burimet e deklaruara prej subjektit në DIPP-në e vitit 2003 “paga personale, pensioni i nënës, të ardhura familjare nga vëllai emigrant në Greqi dhe motra emigrante në SHBA” kanë shërbyer për krijimin e të dyja shumave të deklaruara në rubrikën “Vlefë në milion lekë ose në valutë” dhe, për këtë arsye, është bërë një deklaram i vetëm për të dyja vlerat. Gjithashtu, subjekti është shprehur se paqartësitë e tij në mënyrën e përshkrimit të burimit për çdo pasuri kanë lindur për shkak të formatit të DIPP-së së vitit 2003.

36. Subjekti ka paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e bashkëshortit të motrës së tij nga SHBA-ja, të cilat pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës së një familjeje të përbërë nga 4 persona në SHBA, kanë rezultuar në masën 41.906 USD dhe që justifikojnë dhurimin e shumave të pretenduara (1.500 – 2.500 USD/vit). Edhe duke konsideruar vlerën minimale prej 1.500 USD/vit do të ishin të mjaftueshme për të zëruar balancën negative në muajin gusht të vitit 2003.
37. Subjekti ka paraqitur edhe një relacion financiar, të përgatitur nga një ekspert privat, në të cilin janë analizuar kursimet e nënës nga pensioni, dhurimet nga motra dhe vëllai, mundësinë e këtyre të fundit për të dhuruar shumat në favor të nënës.
38. Në përfundim, lidhur me shumat e disponuara në vitin 2003, eksperti kontabël ka arritur në përfundimin se vajza e znj. Sh. ka pasur mundësi për kursim dhe për t’i dërguar nënës së saj shuma të caktuara çdo vit dhe z. Gurakuqi ka pasur mundësi financiare të mjaftueshme për të depozituar shumën 4.200 euro deri në gusht të vitit 2003.
39. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se diferencën e rezultuar në gusht të vitit 2003, subjekti ka pasur mundësi financiare për ta përballuar me kursimet kumulative të nënës, nga shumat e dhëna nga motra dhe vëllai i z. Gurakuqi për nënën.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

40. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaramet periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore – arsyeton se:
41. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të dhuruara nga motra, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumente të reja mbi të ardhurat e bashkëshortit të motrës së tij (asokohe) në SHBA, Komisioni vlerëson që t’i konsiderojë ato në analizën financiare. Për rrjedhojë, ka rezultuar se këto të ardhura shtesë justifikojnë

burimin e ligjshëm për dhurimin e shumave të pretenduara (1.500 – 2.500 USD/vit) përgjatë periudhës 2000 – 2003.

42. Lidhur me vitet e mëpasshme, nisur nga detyrimi për deklarimin e të ardhurave/dhurimeve apo gjendjeve *cash*, ky burim mund të konsiderohet si i përdorshëm nga subjekti, vetëm në masën dhe në vitin/periudhën që këto dhurata mund të jenë deklaruar prej subjektit në DIPP-të përkatëse, pikërisht si një e ardhur apo si gjendje *cash* e mbartur. Gjithsesi, Komisioni vëren se, edhe duke u konsideruar një kontribut në vlerën minimale prej 1.500 USD/vit, shuma prej 6.000 USD do të mjaftonte për të zëruar balancën negative të konstatuar më herët deri në muajin gusht të vitit 2003, - kështu pa qenë nevoja e konsiderimit dhe përlllogaritjes së shumave të pretenduara si të përfituara në periudhën e mëpasme.
43. Nisur nga dispozitat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 – i cili parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive – Komisioni i ka kërkuar subjektit dokumentacionin përkatës, i cili e ka paraqitur atë.
44. Në këto kushte, trupi gjykues, nisur nga rrethanat, koha e largët dhe provat e depozituara, e vlerëson bindës deklarimin e personit tjetër të lidhur, lidhur me burimet, dhurimet, mënyrat, masën dhe gradualitetin e transferimit të tyre nga SHBA-ja në Shqipëri.
45. Përpos sa më sipër, Komisioni konsideron edhe kontekstin e marrëdhënieve të posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasen M. K., të cilët rezultojnë të jenë motër e vëlla. Në këtë këndvështrim, Komisioni e vlerëson bindëse ekzistencën e ndihmave financiare graduale, të motrës dhe vëllait të subjektit, që i kanë dërguar nënës së tyre, e cila bashkëjetonte me subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, fakti që personi tjetër i lidhur është treguar aktiv gjatë procesit, duke vënë në dispozicion dokumentacionin që provon të ardhurat e saj, çmohet se përmbush kriterin e konfirmimit të kësaj marrëdhënieje, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
46. Për sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen në analizën financiare të kursimeve të padeklaruara të nënës ndër vite, sikurse edhe për gjendjen *cash* të bashkëshortes së subjektit, Komisioni vëren se nuk mund të përfshijë në analizë financiare gjendje *cash* në banesë, nëse ato nuk janë deklaruar ndër vite nga subjekti si të tilla. Kjo pasi, sikurse është qartësuar nga jurisprudenca e konsoliduar, gjendja *cash* që rrjedh nga kursime të mundshme vjetore nuk mund të prezumohet (pas shumë vitesh) duke u bazuar vetëm në marzhet e mundësive financiaro-matematikore, të cilat mund të lënë hapësirë për kursime hipotetike në fund të vitit, por do të duhet të ishin deklaruar ndër vite apo të mund të provohen me mjete alternative plotësuese (nëse ka).
47. Lidhur me detyrimin për deklarimin e likuiditeteve *cash*, vlen të përmendet se ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 4 parashikonte se: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të*

*çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.* Formulari i deklarimit të pasurisë (prej vitit 2004) në faqen 3 ka përshkruar mënyrën se si duhen deklaruar interesat, duke iu referuar nenit 4, geramat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

48. Për sa parashikuar më sipër, ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të interesave privatë përcaktojnë detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë, midis të tjerave, sipas rastit, gjendjen e likuiditeteve *cash*. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën vjetore të vitit 2003, që të mund të merrej parasysh në analizën financiare të vitit 2004, Komisioni nuk mund t’i konsiderojë si burime të ligjshme dhe nuk e ka përfshirë në analizën financiare gjendjen e likuiditeteve të pretenduara për vitin 2004.
49. Lidhur me mos pasjen e detyrimit për deklarim nga nëna e subjektit dhe me pretendimin e subjektit se, për rrjedhojë, duhej që asaj t’i konsiderohen mundësi të akumulimit *cash* ndër vite, Komisioni vlerëson se ky pretendim, ndonëse në pjesën e parë (parashtruese) gjendet i bazuar, nuk çmohet i mjaftueshëm për të kaluar testin e provueshmërisë së gjendjes *cash* të nënës, të disponuara më pas nga subjekti. Kjo pasi, së pari, subjekti ndër vite ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga pensioni i nënës – ndonëse nuk kishte detyrim – e, kësaj, për analogji do të kishte deklaruar edhe gjendjen *cash* të saj, për sa kohë ishin në një ekonomi familjare të përbashkët. Së dyti, duhet pasur parasysh fakti se, meqenëse subjekti pretendon që të konsiderohen të ndara kursimet e nënës – pasi ai nuk kishte dijani në kohë reale – atëherë ato, në momentin që do të ishin njohur/materializuar si gjendje *cash* në banesë që ai kishte përfutur dhe disponuar, do të duhej t’i deklaronte si të tilla në vitin e shpenzimit. Në mungesë të një dokumentacioni të kohës, apo gjurme tjetër, pretendimet e sotme për gjendjen *cash* të padeklaruar mbeten në nivel deklarativ.
50. Komisioni, në vijim të sa është shprehur më sipër lidhur me argumentet për konsiderimin e gjendjeve *cash* ndër vite, si dhe në referencë të jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit<sup>18</sup>, vlerëson se nuk mund të pranojë pretendimin (e prezumuar) e disponimit dhe përdorimit nga subjekti të gjendjes *cash*, si burim për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë gjenerimi, kursimi dhe ruajtja në gjendje *cash* të shumave përkatëse nuk është deklaruar në mënyrë të qartë në deklaratat periodike – si e vetmja formë që mund të provonte ekzistencën e tyre<sup>19</sup> *de facto*. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për konsiderimin e gjendjeve *cash* të padeklaruar në deklaratat periodike, gjendet i pambështetur në ligj, për sa kohë që ligji ka përcaktuar një detyrim eksplicit të subjekteve deklaruese për të deklaruar pasuritë e tyre në vite, përfshirë pasurinë likuiditet në gjendje *cash*, dhe ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 e tij, u jep vlerën e provës *prima facie* pikërisht këtyre deklaratave periodike. Po ashtu, me të njëjtin arsyetim të parashtruar më

<sup>18</sup> Vendimet e Kolegjit: nr. 7/2019 (JR), paragrafi 32.5; nr. 29/2019 (JR), paragrafi 31; nr. 1/2020 (JR), paragrafi 50; nr. 31/2021 (JR), paragrafi 25.2; nr. 26/2022 (JR), paragrafi 18.7.

<sup>19</sup> Në vendimin (JR) nr. 7/2019, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, ka orientuar Komisionin që të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.

sipër, Komisioni ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të kursimeve të nënës nga të ardhurat nga pensioni, për sa kohë këto të ardhura janë përfshirë në ekonominë e përbashkët familjare dhe nuk janë deklaruar si gjendje *cash*, sikurse janë deklaruar të ardhurat nga pensioni i nënës ndër vite. Në përfundim të sa më sipër, konstatimet për mungesën e burimeve të ligjshme financiare, në masat -402.536 lekë dhe -206.655 lekë (të vitit 2005), mbeten të pandryshuara.

51. Megjithatë, në konkluzion, për sa i përket kësaj pasurie, Komisioni çmon se, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe duke mbajtur në konsideratë masën e kësaj pamjaftueshmërie, ajo nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk mund të përbëjë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por do të mbahet në konsideratë për t'u vlerësuar në një kontekst gjithëpërfshirës, në raport edhe me konstatime të tjera sa i takon kriterit të pasurisë.

## **2. Apartament banimi me sipërfaqe 61 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, në vlerën 4.600.000 lekë**

52. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2009 dhe më pas në deklaratën *Vetting*, në vlerën 4.600.000 lekë, sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 12.5.2009<sup>20</sup>. Në këtë kontratë është përshkruar se kësti prej 4.000.000 lekësh është likuiduar në datën 12.5.2009, jashtë zyrës noteriale. Ndërsa, kësti i dytë prej 600.000 lekësh do të likuidohej në momentin e dorëzimit të apartamentit.

53. Si burim për krijimin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer këto të ardhura: (i) hua në shumën 2.000.000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 21.2.2009, me znj. H. H. (Ç.); (ii) hua në shumën 2.000.000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 2.3.2009, me z. A. B.; (iii) shuma 600.000 lekë nga kursimet familjare.

54. Subjekti ka deklaruar se shpenzimet për mobilim të apartamentit kanë qenë rreth 150.000 – 200.000 lekë, me të ardhurat familjare nga punësimi, të kryera përpara sesa të jepej me qira ky apartament.

55. ASHK-ja<sup>21</sup> ka konfirmuar shitjen e pasurisë në analizë sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 15.12.2010, të lidhur me shoqërinë shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar edhe pagesën e pjesës së mbetur prej 600.000 lekësh.

56. UKT-ja<sup>22</sup> nuk ka konfirmuar kontratë në emër të subjektit apo personave të lidhur për pasurinë në analizë, ndërsa FSHU-ja ka konfirmuar kontratën e lidhur për furnizimin me energji elektrike të pasurisë në analizë.

57. Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, çmimi mesatar i shitjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2009, zona 2/2, ka qenë 123.000 lekë/m<sup>2</sup>, çka do të rezultonte në një çmim për apartamentin e porositur nga subjekti, rreth 7.503.000 lekë në

<sup>20</sup> Subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë së apartamentit nr. \*\*\*, datë 11.12.2013.

<sup>21</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2017, është përcjellë përgjigjja e ZVRPP-së Tiranë.

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2022.

krahasim me çmimin e aplikuar prej 4.600.000 lekësh.

58. Në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti ka deklaruar se çmimi për zonën ku ndodhet apartamenti është 70.500 lekë/m<sup>2</sup>, çmim ky i përafërt me çmimin e aplikuar 68.656 lekë/m<sup>2</sup>. Kushti i vetëm për përfitimin e çmimit të favorshëm ishte se duhet të parapaguhej thuajse e gjithë vlera e banesës, me përjashtim të një vlere që do të paguhej në momentin e lëshimit të certifikatës së pronësisë. Subjekti ka shtuar se edhe në vitin 2020, pas 11 vitesh, prona është rivlerësuar me çmimet e tregut në shumën 7.471.280 lekë, sërish më e vogël se vlera 7.503.000 lekë. Në vitin 2021, ky apartament është shitur nga subjekti në shumën 60.000 euro<sup>23</sup>. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës disa kontrata shitblerjeje, nga shqyrtimi i të cilave provohet se në objektin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. apartamentet janë shitur me çmim të përafërt me atë të blerjes së apartamentit prej tij.
59. Po ashtu, në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 7, subjekti ka paraqitur me anë të postës elektronike të datës 16.3.2023 edhe një raport vlerësimi, në të cilin konfirmohet sa më lart – shpjeguar nga subjekti.
60. Subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie dhe nuk ka trajtuar asnjë kallëzim apo procedim penal lidhur me z. T. Ç., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (përfshirë edhe ortakët), çka është konfirmuar edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>24</sup>.
61. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se pasuria në fjalë ishte e hipotekuar në favor të BKT-së, sipas kontratës së hipotekimit nr. \*\*\*, datë 17.6.2015, për të siguruar kredinë e marrë nga znj. Ç. dhe z. V. në shumën 5.000.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se duke qenë se shtetasit e sipërpërmendur kishin porositur një apartament të ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në Komunën Dajt, në të cilin bashkëshortja e tij kishte investuar dhe nuk posedonin pasuri për të vendosur në hipotekë, subjekti kishte vënë si garanci apartamentin e tij deri në momentin e regjistrimit të apartamentit të porositur prej tyre. Në vijim, garancia është zëvendësuar me apartamentin e subjektit të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, për shkak se ai donte të shiste apartamentin e bllokuar nga banka më herët. Sa më sipër, është konfirmuar edhe nga dosja e plotë e kredisë e paraqitur nga BKT-ja me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2023.
62. Për sa i përket marrëdhënies me shtetasit E. Ç. dhe A. V., subjekti ka deklaruar se nuk ka trajtuar asnjë kallëzim apo procedim penal, çka është konfirmuar edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>25</sup>.

## **2.1 Lidhur me analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë**

63. Sikurse u përmend edhe më sipër, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit në analizë si burim ka shërbyer huaja sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 21.2.2009, me anë të së cilës znj. H. H. (Ç.) i ka dhënë hua shumën 2.000.000 lekë, si dhe huaja sipas

---

<sup>23</sup> Subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes së kësaj pasurie nr. \*\*\*, datë 20.10.2021, në favor të palës blerëse, znj.K. M. Edhe nga verifikimi i kryer nga *online*, në sistemin multifunksional të ASHK-së, ka rezultuar se pasuria figuron e regjistruar në emër të shtetas K. M.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022.

<sup>25</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022.



kontratës nr. \*\*\*, datë 2.3.2009, me anë të së cilës z. A. B. i ka dhënë hua shumën 2.000.000 lekë. Pjesa prej 600.000 lekësh është paguar nga kursimet familjare.

64. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit në DIPP-të ndër vite ka rezultuar deklarimi i marrjes së këtyre huave në vitin 2009, por nuk është deklaruar ndonjë shlyerje e tyre, së paku deri në deklaratën *Vetting*.
65. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka bërë me dije se znj. H. H. është vjehrra e tij, ndërsa z. B. një mik i ngushtë i familjes. Gjithashtu, në këtë pyetësor, ai ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 24.4.2018, në të cilën znj. H. H. ka deklaruar se subjekti i rivlerësimit i ka likuiduar shumën prej 800.000 lekësh. Më pas, me anë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 22.12.2018, znj. H. H. ka deklaruar se e ka konsideruar të shlyer huan, pas likuidimeve të shumës prej 1.200.000 lekësh nëpërmjet transfertave bankare të datave 7.12.2018 dhe 12.12.2018 nga llogaria e subjektit në llogarinë e saj në “Tirana Bank”.

## **2.2 Lidhur me huan nga znj. H. H. në vlerën 2.000.000 lekë**

66. Referuar kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 21.2.2009, znj. H. H. i ka dhënë hua shumën 2.000.000 lekë huamarrësit Armand Gurakuqi. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të vjehrrës së tij, subjekti, në përgjigjet e tij të pyetësorit nr. 1, ka bërë me dije se për këtë kanë shërbyer të ardhurat nga: (i) veprimtaria e ushtruar prej saj si rrobaqepëse dhe tregtare ambulante në P.; (ii) shitja e një dyqani dhe një apartamenti në P.; si dhe (iii) një kontratë huaje e lidhur mes zonjës në fjalë dhe një personi të afërm të saj, për marrjen e shumës prej 2.000.000 lekësh.
67. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, dokumentacionin si vijon:
- kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 26.12.2007, e lidhur mes shtetasve Sh. H. H., H. H. dhe A. H. H., në cilësinë e palës shitëse dhe shtetas M. B. në cilësinë e palës blerëse, nëpërmjet së cilës kanë shitur një apartament kundrejt çmimit 1.000.000 lekë;
  - kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 26.12.2007, e lidhur mes shtetasit Sh. H. H. në cilësinë e palës shitëse dhe shtetas M. B. në cilësinë e palës blerëse, nëpërmjet së cilës ka shitur një pasuri të cilësuar si “shtesë pallati”, kundrejt çmimit 500.000 lekë;
  - deklaratë datë 1.10.2008 (të panoterizuar), me anë të së cilës znj. H. H. ka marrë hua shumën prej 2.000.000 lekësh nga z. A. M.
68. Sa i përket të ardhurave të vjehrrës së tij nga ushtrimi i veprimtarisë si rrobaqepëse apo tregtare ambulante, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka bërë me dije se për shkak të kohës së gjatë nuk mund të sigurojë të dhënat e kërkuara. Ai ka paraqitur një deklaratë noteriale të nënshkruar mes znj. H. H. dhe z. M., nr. \*\*\*, të datës 17.7.2020, në të cilën palët kanë deklaruar se në këtë datë znj. H. H. ka likuiduar përmes bankës huan e marrë prej 2.000.000 lekësh nga z. M. sipas mandatit të datës 17.7.2020<sup>26</sup>, me përshkrimin “kalim fondi sipas deklaratës për dhënie huaje, datë 1.10.2008, për qëllime ndihmëse ekonomiko-familjare”.

---

<sup>26</sup> Të paraqitur si provë në përgjigje të pyetësorit nr. 5.

69. Në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësit, z. A. M. – sipas deklaratës noteriale të paraqitur me përgjigjet e pyetësorit nr. 1 – subjekti ka paraqitur edhe dokumentacionin si vijon:

- ekstrakt nga QKB-ja i shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k. (ku z. M. rezulton ortak me 30% të aksioneve dhe administrator deri në vitin 2011);
- vërtetim page nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. për të ardhurat e përfituara nga z. M. në periudhën shtator 2004 – tetor 2011;
- ekstrakt nga QKB-ja i shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k. (ku z. M. rezulton ortak me 100% të aksioneve);
- ekstrakt nga QKB-ja i shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k. (ku z. M. rezulton ortak me 33.3% të aksioneve dhe administrator prej datës 4.5.2007);
- vërtetim nga ISSH-ja për pagimin e kontributeve për z. M. nga shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe për pagimin e kontributeve nga znj. E. M. (bashkëshortja e z. M.) nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

70. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti nuk ka rezultuar që shoqëritë e sipërcituara të kenë shpërndarë dividend. Ndërsa, nga vërtetimet e pagave kanë rezultuar të ardhura nga pagat të z. M. dhe bashkëshortes së tij, përgjatë periudhës 2004 – tetor 2008 (momenti i dhënies së huas) – në shumën 4.268.436 lekë, të cilat pas përlllogaritjes dhe shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë kanë rezultuar të mjaftueshme për të dhënë huan në fjalë, në favor të vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, me burime të ligjshme financiare.

**Tabela nr. 6** – analiza e burimeve për z. M.

Të ardhura 2004 - tetor 2008	4,268,436
Shpenzime jetese 2004 - tetor 2008	(1,336,772)
Dhene hua vjehrrës se subjektit	(2,000,000)
<b>Rezultati</b>	<b>931,665</b>

71. I pyetur nga Komisioni në pyetësorin nr. 7 lidhur me vendbanimin e familjes së vjehrrës së tij, pas shitjes së pasurive të paluajtshme të disponuara prej saj në P., subjekti ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes së tij, në datën 6.11.2007, përpara shitjes së pasurive të paluajtshme në datën 26.12.2007, kishin blerë një apartament në Durrës në vlerën 3.250.000 lekë. Subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, datë 1.3.2023, të lëshuar nga vjehrra e tij, znj. H. H., ku ka konfirmuar sa më sipër dhe ka bërë me dije se kontrata e shitblerjes për apartamentin e ri ende nuk është nënshkruar mes palëve, pasi kjo pasuri nuk është regjistruar ende në ASHK. Për rrjedhojë, të ardhurat nga shitja e pasurive të tyre në P. ishin të disponueshme për t’iu dhënë hua subjektit.

72. Në përfundim të sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë të faktit që huaja e marrë nga vjehrra e subjektit të rivlerësimit tek z. M., ndonëse ka prova të kthimit të saj me transfertë bankare, mbetet vetëm në nivel deklarativ për sa i përket fazës fillestare të marrëdhënies. Fakti që ky pretendim është ngritur për herë të parë në përgjigjet e dhëna nga subjekti të pyetësorit nr. 1 – përgjatë procesit të rivlerësimit dhe që nuk ishte deklaruar më herët në deklaratat vjetore apo atë *Vetting*, në këtë rast nuk mund të mos përbëjë në vetvete pengesë

për ta konsideruar, pasi është burim i huadhënësës dhe jo direkt i subjektit.

73. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 7, subjekti ka paraqitur një procesverbal të mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 19.7.2016, për shpjegimet e dhëna nga subjekti, si dhe për administrim të dokumentacionit justifikues, ku rezulton të jetë depozituar dokumenti deklarativ për dhënie huaje nga z. A. M. në favor të znj. H. H., e datës 1.10.2008, në shumën 2.000.000 lekë.
74. Megjithatë, nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë mjetet financiare të huas nga z.M., pasi: (i) vetë marrja e kësaj huaje (nga vjehrra tek z. M.) nuk ka rezultuar e provuar me dokumente të kohës lidhur me momentin dhe mënyrën e kalimit – veç kthimit të kryer me transfertë bankare përgjatë procesit të rivlerësimit; (ii) referuar deklaratës së dhënies së kësaj huaje, shuma në fjalë ka pasur destinacionin për ndihmë ekonomike familjare dhe jo për t’u dhënë hua prej saj në vijim. Kjo pasi rrethanat konkrete dhe pretendimet e subjektit, të bazuara në deklaratat të lëshuara përgjatë procesit të rivlerësimit, nuk mjaftojnë për të konsideruar të provuar përfitimin, disponimin dhe përdorimin e kësaj shume nga subjekti, si një burim për këtë pasuri. Në këtë kontekst, vërehet edhe fakti se vetë njohja midis vjehrrës së subjektit dhe huadhënësit ka rezultuar – nga vetë shpjegimet e subjektit përgjatë seancës dëgjimore – të ketë qenë jo e hershme, por pas transferimit të vjehrrës (dhe vjehrrit) në qytetin e Durrësit – ku edhe do të investohej huaja e marrë nga z. M. për krijimin e një laborator/ambienti rrobaqepësie. Kësisoj, Komisioni çmon se mbeti i paprovuar dhe jo bindës pretendimi i marrjes dhe destinacioni i huas nga z. M., pra që të jetë përfituar (në mënyrë indirekte) dhe përdorur nga subjekti i rivlerësimit.
75. Për sa u përket burimeve financiare të vetë familjes së huadhënësës (vjehrrës së subjektit), të realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme të lartpërmendura (të cilat në vetvete, gjithsesi, nuk do të ishin të mjaftueshme për të justifikuar huan) – nisur nga afati i shkurtër kohor, mes blerjes së pasurisë në Durrës prej vjehrrit të subjektit dhe shitjes së pasurive të ndodhur në P. prej tyre dhe në mungesë të burimeve alternative – Komisioni konsideron se këto të ardhura, realizuar nga shitja e pasurive të paluajtshme, mund të jenë disponuar më herët dhe të jenë përdorur për blerjen e pasurisë së ndodhur në qytetin e Durrësit. Kjo, pasi pamundësia e burimeve të tjera alternative nga vjehri dhe vjehrra e subjektit për përballimin financiar të blerjes së banesës në Durrës çon në logjikën e thjeshtë të përdorimit të shumave të realizuara nga shitja e ndërtesës në P. dhe jo në dhënien hua të kësaj shume për një investim të një banese të dytë nga ana e subjektit.

Nisur nga sa më lart dhe nga fakti që nuk është paraqitur ndonjë dokument ligjor për të provuar përdorimin e këtij burimi apo ndonjë burim tjetër të ardhurash (nga punësime të mundshme të vjehrrës apo vjehrrit të subjektit, etj.), që të kënaqë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës – përpos fotografive dhe deklarimeve lidhur me aktivitetin e ushtruar nga znj. H. H. si rrobaqepëse – Komisioni nuk e ka përlllogaritur huan e marrë nga kjo e fundit, mes të ardhurave të ligjshme të përdorura nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie.

### **2.3 Lidhur me huan e marrë nga shtetasi A. B., në vlerën 2.000.000 lekë**

76. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se për kontratën nr. \*\*\*, datë 2.3.2009,

lidhur mes tij dhe shtetasit A. B., për dhënien hua të shumës 2.000.000 lekë, me afat shlyerjeje 10 vjet, subjekti nuk ka shlyer asnjë pjesë të detyrimit. Subjekti ka shpjeguar se z. B. ka ushtruar aktivitet në prodhimin dhe shitjen e birrës në Elbasan, por nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion<sup>27</sup> që të provojë të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet, të cilat do të mundësonin dhënien e huas në fjalë.

77. Komisioni, duke analizuar situatën faktike në kuptim të përcaktimit të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka barrën të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie e cila i dhurohet ose i jepet hua prej personit tjetër të lidhur, në këtë rast, të shumës prej 2.000.000 lekësh.
78. Në kuptim të kësaj dispozite dhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se analizimi i rrethanave të faktit në rastin konkret duhet të fokusohet në dy aspekte: Së pari, nëse provohet se personi tjetër i lidhur mundej t'i realizonte këto të ardhura (shumën prej 2.000.000 lekësh) me burime të ligjshme. Për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, trupi gjykues mori në konsideratë faktin se përgjatë periudhës 2000 – 2009, e cila u konsiderua si e arsyeshme të merrej parasysh për shkak të një arsytimi logjik se verifikimi i të ardhurave të personit tjetër të lidhur jo detyrimisht duhet të përfshijë të gjithë periudhën e punësimit të tij, por aq sa është e përshtatshme/nevojshme dhe proporcionale në lidhje me shtrirjen në kohë të krijimit të pasurisë, për sa nuk rezultojnë pretendime apo fakte që e lidhin fitimin e saj me një moment të caktuar kohor, me qëllim provimin e ligjshmërisë së burimit për vlerën që është objekt huaje. Së dyti, nëse pas një vlerësimi logjik dhe të përgjithshëm të çdo rasti, personi tjetër i lidhur kishte mundësi t'ia jepte hua këtë shumë subjektit të rivlerësimit. Për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, trupi gjykues vlerësoi të analizojë faktin nëse me këto të ardhura të realizuara prej personit tjetër të lidhur, a mundej ai sipas një vlerësimi të arsyeshëm të të gjitha rrethanave të jepte hua shumën e pretenduar. Pjesë e këtij vlerësimi është edhe raporti që krijohet mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve për jetesë të personit tjetër të lidhur për periudhën që analizohet, për sa kohë që nuk rezulton ndonjë pretendim tjetër i subjektit të rivlerësimit se ai realizonte të ardhura prej ndonjë burimi tjetër të ligjshëm, por të paverifikuar.
79. DRT Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2018, ka konfirmuar se shtetasi A. B. ka qenë i regjistruar me aktivitet tregtar, me nr. NIPT \*\*\*, me objekt aktiviteti “prodhim e tregtim birre, bar-kafe” në L. F., regjistruar në gjykatë me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.1999 dhe aktualisht figuron me status “pasiv” prej datës 5.4.2013. DRT-ja ka bërë me dije se tatimpaguesi ka deklaruar tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2005, me totalin e shitjeve në vlerën 2.000.000 lekë, ndërsa në vitet 2003, 2004, 2006, 2007 dhe 2008 nuk ka pasur deklarim për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin. Nisur nga forma ligjore e këtij aktiviteti, si person fizik – referuar edhe konceptit të ligjit tregtar mbi mospasjen e personalitetit

---

<sup>27</sup> Subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 20.12.2018, nga DTTV Elbasan, nga i cili ka rezultuar se z. B., me NIPT \*\*\*, me aktivitet “tregti birre”, nuk rezultonte debitor deri në datën 31.12.2015.

juridik të ndryshëm – ai nuk ka detyrim për dorëzimin e vendimit të ortakëve mbi destinimin e fitimit apo për shpërndarje të dividendëve, duke e lënë kështu fitimin në disponim të plotë të pronarit të njësisë ekonomike të biznesit.

80. Komisioni i është drejtuar gjithashtu Bashkisë Elbasan, për të paraqitur të dhëna të mundshme financiare të disponuara nga ky institucion për aktivitetin e mësipërm. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Bashkia Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2022, ka paraqitur dokumentacionin e dorëzuar prej z. B. përgjatë viteve 2007 – 2013, periudhë në të cilën DTTV-ja ka qenë autoriteti kompetent pranë të cilit raportohej mbi qarkullimin e deklaruar/parashikuar ndër vite. Nga të dhënat e disponuara nga Bashkia Elbasan ka rezultuar deklarimi dhe parashikimi i xhirove vjetore, si vijon:
- 2005 – 2.000.000 lekë;
  - 2006 – 3.000.000 lekë;
  - 2007 – 3.000.000 lekë;
  - 2008 – 1.600.000 lekë;
  - 2009 – 1.600.000 lekë.
81. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur disa mandatpagesa të detyrimeve tatimore, taksave vendore dhe kontributeve përgjatë periudhës 2000 – 2005. Ndonëse nuk janë paraqitur pagesat e periudhave të mëvonshme, nisur nga vërtetimi mbi detyrimet në kohë reale, bashkëngjitur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2018, nga DRT-ja Elbasan, nuk ka rezultuar detyrim për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, çka konfirmon pagesën e detyrimeve tatimore për këtë aktivitet.
82. Po ashtu, nisur nga mandatpagesat për tarifën e paguara për tatimin e fitimit të thjeshtuar dhe parashikimet ligjore për vitet përkatëse – referuar ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, i ndryshuar – mund të përcaktohet niveli i xhiros vjetore edhe për periudhat përpara vitit 2005. Referuar shumës së tatimit të paguar dhe kategorizimit<sup>28</sup> të bizneseve në ligjin e sipërcituar, duket se z. B., për periudhën 2000 – 2004, ka paguar tatimin për xhiro deri në 2.000.000 lekë.
83. Nga sa më sipër, duket se përgjatë periudhës 2000 – shkurt 2009 aktiviteti i huadhënësit ka realizuar një xhiro prej 19.866.667 lekësh. Përgjatë së njëjtës periudhë, shpenzimet e jetesës për familjen e huadhënësit (5 anëtarë) do të rezultonin në masën 4.925.243 lekë.
84. Në mungesë të të dhënave konkrete mbi fitimet e realizuara nga ky aktivitet, Komisioni i ka kërkuar DRT-së Elbasan për të paraqitur çdo dokumentacion të mundshëm të ndodhur në dosjen fizike të tatimpaguesit, si dhe për të bërë me dije mbi të dhëna statistikore të mundshme të disponuara për marzhin e fitimit *bruto* për këtë lloj aktiviteti. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, DRT Elbasan ka paraqitur një vetëdeklarim të vitit 2005, si dhe ka bërë me dije se nuk disponohen të dhëna statistikore lidhur me marzhin *bruto* të këtij lloj aktiviteti gjatë periudhës tatimore të kërkuar.

---

<sup>28</sup> Neni 3 i ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, parashikon se subjekte të tatimit me kuotë fikse janë ato subjekte që realizojnë një qarkullim deri në shumën 2.000.000 lekë/vit. Gjithashtu, tatimi me kuotë fikse, për sektorin e prodhimit, kategoria II (ku përfshihet qyteti i Elbasanit), është 60.000 lekë/vit.

85. DPT-ja<sup>29</sup> ka bërë me dije se nga të dhënat e përpunuara nga ky institucion, lidhur me disa nga shoqëritë që kanë operuar në fushën e prodhimit dhe tregtimit të birrës, që kanë rezultuar me fitim, kanë pasur një marzh fitimi përgjatë viteve 2018 – 2021, duke filluar nga më i ulëti 1% dhe më i larti 66%.
86. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2022, nga Sh. P. B. V., e cila, ndër të tjera, ka sqaruar se përqindja e fitimit për një litër birrë vendase ka qenë rreth 50%. Sipas analizës së aktivitetit të shoqërisë në fjalë, të kryer nga një ekspert i përzgjedhur nga subjekti, do të rezultonte një fitim *bruto* prej 9.670.046 lekësh – vlerë kjo që sipas sqarimeve të subjektit ishte e mjaftueshme për të mundësuar dhënien e shumës së huas nga z. B.
87. Komisioni ka përllogaritur, në vijim të sa më sipër, mundësinë e huadhënësit për të mbuluar shpenzimet<sup>30</sup> e jetesës së familjes së tij, si dhe për të dhënë huan në fjalë subjektit të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë variantin e paraqitur nga subjekti me të dhënat e Shoqatës së prodhimit të birrës vendase, për një marzh fitimi të mundshëm prej 50%, në përfundim të së cilës do të rezultonte një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare të huadhënësit.
88. Gjithashtu, Komisioni ka përllogaritur edhe variantin alternativ, duke e konsideruar marzhin e fitimit të këtij aktivitetit në mesataren aritmetike të marzheve të fitimit të paraqitura nga DPT-ja, në vlerën prej 33% të xhiros. Vlen të theksohet fakti që duke filluar nga muaji qershor 2008, në objektin e aktivitetit të z. B. është shtuar edhe bar-kafe, aktivitet i cili mund të ketë një marzh fitimi më të lartë se prodhimi, çka – ndonëse për një periudhë 8-mujore – mund të ketë ndikuar pozitivisht në rritjen e marzhit të përgjithshëm.
89. ASHK Elbasan ka paraqitur dy kontrata shitblerjeje, në të cilat z. B. ka qenë në cilësinë e palës shitëse. Nga këto transaksione janë realizuar përkatësisht të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme në masën 2.000.000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 26.5.2004 dhe në masën 500.000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 16.1.2004.
90. Nga sa më sipër, duket se në të dy variantet e përllogaritura nga Komisioni ka pasur një mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare të rezultuara nga hetimi i kryer për huadhënësin A. B., për dhënien e huas në masën 2.000.000 lekë, në favor subjektit të rivlerësimit.

**Tabela nr. 7** – analiza e burimeve për dhënien e huas prej 2.000.000 lekësh

Xhiro e aktivitetit 2000 - shkurt 2009	19,866,667	19,866,667
Marzhi i fitimit	33%	50%
<b>Fitimi neto pas tatimit 2000 - shkurt 2009</b>	<b>6,083,500</b>	<b>9,460,833</b>
<b>Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme</b>	<b>2,500,000</b>	<b>2,500,000</b>
Shpenzime jetese 2000 - shkurt 2009 (5 persona)	(4,925,243)	(4,925,243)
Dhene hua subjektit	(2,000,000)	(2,000,000)
<b>Rezultati</b>	<b>1,658,258</b>	<b>5,035,591</b>

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2023.

<sup>30</sup> Të përllogaritura nga Komisioni në bazë të të dhënave të INSTAT-it/frymë, për 5 persona, referuar të dhënave nga gjendja civile.

91. Komisioni ka kërkuar gjithashtu informacion<sup>31</sup> mbi llogaritë bankare të shtetasit A. B. dhe aktivitetit të tij deri në momentin e dhënies së huas dhe nga verifikimi i përgjigjeve të bankave të nivelit të dytë nuk ka rezultuar ndonjë veprim tërheqjeje *cash* me vlerë të konsiderueshme përgjatë periudhës së kërkuar. Po ashtu, DPSHTRR-ja<sup>32</sup> ka bërë me dije se deri më 31.3.2009 shtetasi A. B. në periudha të ndryshme ka pasur në pronësi 5 automjete, lidhur me të cilat nuk njihen momentet dhe çmimet e blerjeve apo të shitjeve të tyre, pasi nuk disponohen kontratat përkatëse.
92. Sipas analizës së kryer në këtë këndvështrim (duke konsideruar marzhin e fitimit 50%) rezultoi se personi tjetër i lidhur kishte realizuar deri në momentin e dhënies së huas të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, shumën prej 5.035.591 lekësh, e cila përfshin shumën prej 2.000.000 lekësh të dhënë hua subjektit të rivlerësimit.
93. Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>33</sup>, vlerëson se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur. Nisur nga sa më sipër, kjo hua është konsideruar nga Komisioni, për sa kohë krijohet bindja se huadhënësi A. B. ka pasur burime të ligjshme dhe disponibilitetit financiar për të përdorur këto të ardhura edhe për këtë huadhënie. Subjekti ka deklaruar se me shtetasin A.B. ka miqësi familjare të hershme dhe se nuk ka trajtuar asnjë kallëzim apo procedim penal me të. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera nga Komisioni, nuk ka rezultuar ndonjë konflikt interesi me këtë person.

#### **2.4 Lidhur me kursimet familjare**

94. Referuar deklaratimeve të subjektit, pjesa e mbetur e çmimit të blerjes së pasurisë në analizë prej 600.000 lekësh është likuiduar me anë të kursimeve familjare. Në mungesë të mandatpagesave, Komisioni ka konsideruar si periudhë të likuidimit të kësaj shume datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, 15.12.2010.
95. Nga shqyrtimi i deklaratimeve periodike të subjektit nuk ka rezultuar deklarimi i ndonjë pakësimi të kursimeve të disponuara në *cash*, duke e kufizuar kështu analizën financiare me të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2010. Gjatë këtij viti, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e apartamentit në fjalë, në shumën 225.000 lekë. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur kontratën e qirasë<sup>34</sup> nr. \*\*\*, datë 5.4.2010, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe qiramarrëses J. F., kundrejt çmimit 25.000 lekë/muaj.

<sup>31</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2022.

<sup>32</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2023.

<sup>33</sup> Vendim nr. 20/2019 (JR), datë 31.7.2019.

<sup>34</sup> Në këtë kontratë është parashtruar se subjekti nuk dispononte ende dokumente pronësie, por vetëm kontratën e porosisë së vitit 2009, pasi godina nuk ishte ende regjistruar dhe është specifikuar se apartamenti ka qenë i kompletuar me orendi shtëpiake.

96. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin që provon pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga qiradhënia, pasi nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni nuk ka rezultuar pagimi i tyre. Për pasojë, në këto kushte, këto të ardhura nuk janë konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
97. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2010 ka rezultuar se për të kryer pagesën e pjesës së mbetur të çmimit të apartamentit, si dhe për të mbuluar shpenzimet e familjes gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën -342.552 lekë.

**Tabela nr. 8** – analiza e burimeve për pagesën e kështit të fundit

Të ardhura nga paga e subjektit te vitit 2010	1,139,677
Të ardhura nga paga e b/sjortes te vitit 2010	728,579
Të ardhura nga pensioni i nënës te vitit 2010	164,659
Të ardhura nga qiradhënia 2010	-
Shpenzime jetese 4 persona 2010	(546,480)
Shpenzime udhetimi	(5,772)
Shpenzime për ripagimin e kredisë	(1,591,811)
Pakesim i likuiditeteve ne llogarite bankare	368,595
Pagesë e kështit të fundit të apartamentit	(600,000)
<b>Rezultati i vitit 2010</b>	<b>(342,552)</b>

98. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara, si dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e konstatimeve të mëposhtme:
- *Duket se vjehrra e subjektit nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 2.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit.*
  - *Duket se z. A. B. ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 2.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit.*
  - *Duket se nuk ka logjikë ekonomike në investimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit në këtë pasuri, pasi ai ka përdorur 4 milionë lekë të marra hua, ndërkohë që kontributi i tij për këtë blerje ka qenë vetëm 600.000 lekë, për rrjedhojë ngrihen dyshime mbi vërtetësinë e marrëdhënieve të huave të mësipërme.*
  - *Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën **-1.510.053 lekë** në vitin 2009, si dhe në vlerën **-342.552 lekë** në vitin 2010, për të paguar çmimin e blerjes së apartamentit në analizë dhe për të mbuluar shpenzimet e viteve përkatës.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

99. Subjekti ka paraqitur dy deklarata noteriale aktuale, nga ku njëra e lëshuar nga vjehrra e tij, e cila ka bërë me dije se huan nga z. M. e ka marrë në vitin 2008, me qëllim për të hapur



një repart rrobaqepësie, gjë që nuk u realizua prej saj dhe, për këtë arsye, ata mund t'ia jepnin shumën në fjalë subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, deklarata e dytë noteriale është lëshuar nga shitësja e pasurisë në Durrës, të blerë nga vjehrrit e subjektit, e cila është shprehur se, siç kanë deklaruar edhe në vitin 2007, paratë për blerjen e pasurisë i janë dhënë në ditën e hartimit të kontratës. Subjekti është shprehur se konkluzioni i Komisionit se paratë e realizuara nga shitja e pasurive në P. mund të jenë arkëtuar më herët dhe të jenë përdorur për blerjen e pasurisë në Durrës, nuk është i bazuar në prova.

100. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se duhet të rishikohet qëndrimi i Komisionit lidhur me huan që vjehrra e subjektit ka marrë në datën 1.10.2008 nga shtetasi A. M., duke e përfshirë këtë hua në analizën financiare të blerjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*”, bazuar në arsyet dhe rrethanat si vijon: *“Deklarata e huas është deklaruar nga ana ime në datën 19.7.2016 para inspektorit të ILDKPKI-së. Në të njëjtën datë unë kam depozituar tek inspektori edhe një kopje të deklaratës për dhënie huaje, të datës 1.10.2008, mes vjehrrës sime dhe z. A. M. Është e rëndësishme të theksohet se shpjegimet dhe dorëzimi i deklaratës së huas para inspektorit të ILDKPKI-së janë kryer disa muaj para plotësimit të formularit të pasurisë në kuadër të rivlerësimit. Në këto kushte, provohet qartë se nuk është i bazuar qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit kjo rrethanë është ngritur për herë të parë në përgjigjet e dhëna nga subjekti të pyetësorit nr. 1. Një rrethanë e tillë është pranuar edhe nga vetë Komisioni në të njëjtin paragraf të dokumentit ‘rezultatet e hetimit kryesisht...’. Deklarata për dhënien e huas nga z. M. është shpjeguar pranë ILDKPKI-së në momentin e kryerjes së hetimeve administrative të pasurisë nga ai institucion sipas DIPP-ve dhe jo në kuadër të procesit Vetting. Data 19.7.2016 ka qenë dita e parë në të cilën unë jam pyetur mbi burimet e ligjshme të vjehrrës sime lidhur me huan që më ka dhënë në vitin 2009. Deri në atë moment unë nuk isha pyetur asnjëherë më parë mbi këtë rrethanë. Për këto arsye, në rastin e parë që më janë kërkuar shpjegime mbi këtë marrëdhënie, unë kam vënë në dispozicion edhe aktet përkatëse. Procesverbali i deklarimit të datës 19.7.2016, procesverbali mbi administrimin e dokumentacionit justifikues ligjor i datës 19.7.2016 dhe deklarata për dhënie huaje datë 1.10.2008, e marrë sipas këtij procesverbali, përbëjnë prova në këndvështrimin e Kodit të Procedurave Administrative”.*

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

101. Në konfirmim të analizave vlerësuese dhe konkluduese të shprehura më sipër, në paragrafët/pikat 74 dhe 75 të këtij vendimi, Komisioni ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë mjetet financiare të pretenduara nga huaja nga z. M., si dhe as ato nga vjehrra e subjektit. Ky konkluzion bazohet nga njëra anë tek paprovueshmëria e ekzistencës së marrëdhënies apo momentit dhe mënyrës së marrjes së kësaj shume nga vjehrra e subjektit. Nga ana tjetër, nuk krijohet bindja se kjo hua e përfituar nga vjehrra e subjektit, (edhe nëse është marrë vërtet kur pretendohet – rethanë kjo e paprovuar dhe e paqartë), të ketë pasur realisht subjektin si destinacion dhe përfitues fundor, pra të jetë përdorur prej tij si burim për këtë banesë.
102. Gjithashtu, sikurse është arsyetuar edhe më sipër, vërehet se burimet financiare të vetë familjes së huadhënësës (vjehrrës së subjektit) nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të huas së pretenduar. Kjo pasi burimet nga puna apo

aktiviteti i tyre nuk kanë rezultuar të provuara, sikurse nuk konsiderohet bindës përdorimi për huadhënie i të ardhurave të realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme në P. Ky konkluzion rrjedh pikërisht nga pamundësia e burimeve të tjera alternative nga vjehrrit e subjektit, për përballimin financiar të blerjes së banesës në Durrës dhe, për rrjedhojë, Komisioni çmon se ky investim është mbuluar pikërisht me shumat e realizuara nga shitja e ndërtesës në P. Kësisoj, ky burim financiar (nga shitja) nuk është destinuar në dhënien hua të kësaj shume për një investim të subjektit në një banesë të dytë, por në blerjen prej tyre të një banese për vete. Në këtë rast, Komisioni ka shtrirë analizën logjiko-faktike dhe ka konsideruar edhe parametrat dhe kontekstin financiar më të gjerë të huadhënësve, nisur nga dyshimet e ngritura jo vetëm në raport me kapacitetin financiar të huadhënësve, por edhe në aspektin e *modus operandi* të subjektit, i cili, në mënyrë të përsëritur, ka investuar në të gjitha pasuritë e tij me një kontribut financiar minimal të vetin, duke përdorur në vijimësi mjete monetare me prejardhje nga persona të tretë.

103. Nisur nga sa më lart, në mungesë të ndonjë prove mbi burime të ardhurash, që të kënaqin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni, pasi ka përlllogaritur të ardhurat e ligjshme të përdorura nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie, në raport me shumat e shpenzuara dhe shpenzimet jetike, ka rezultuar një pamundësi financiare në vlerën -1.852.606 lekë, siç ishte njoftuar më herët në rezultatet e hetimit, përkatësisht -1.510.053 lekë në vitin 2009 dhe -342.552 lekë në vitin 2010. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjekti lidhur me burimin e krijimit të kesaj pasurie nuk ka paraqitur plotësisht realitetin dhe për rrjedhojë ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, germat b dhe ç të ligjit nr. 84/2016. Këto konkluzione kualifikohen në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, përbëjnë shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

### **3. Apartament me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*”, Elbasan**

104. Pasuria në fjalë është deklaruar në deklaratën *Vetting* nga nëna e subjektit të rivlerësimit, si pasuri e blerë nga Ndërmarrja Komonale e Banesave, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 28.8.1993, kundrejt çmimit 20.360 lekë.
105. ASHK Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, ka konfirmuar pasurinë e llojit “apartament” me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, ndodhur në z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve S. G. me S. G.
106. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga ASHK Elbasan ka rezultuar se pasuria ishte regjistruar fillimisht në emër të prindërve të subjektit, motrës së tij M. G. dhe vëllait të tij M. B. Më pas, me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 18.10.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së babait të subjektit për deklarimin e pavlefshëm (pjesërisht) të kontratës së shitjes së banesës, për sa i përket fëmijëve të tij M. G. dhe M. B., për shkak se nuk plotësonin kriteret ligjore për të përfutur nga privatizimi i banesave shtetërore. Bazuar në vendimin e gjykatës është lëshuar vërtetimi nga dokumenti hipotekor, ku është regjistruar pasuria vetëm në emër të prindërve të subjektit.
107. Nga sa më sipër, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarimin e pasurisë në fjalë, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

#### **4. Automjet tip “Skoda”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit**

108. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë automjetin tip “Skoda”, me targa \*\*\*, në deklaratën e interesave private në vitin 2011, si dhe më pas në deklaratën *Vetting*. Ai ka bërë me dije se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës së shitjes datë 26.5.2011, nga shoqëria “P. A.”, në vlerën 14.555 euro. Në këtë kontratë është përcaktuar se vlera prej 4.000 euro do të parapaguhej me nënshkrimin e kontratës, ndërsa pjesa tjetër prej 10.555 euro do të likuideohej me dorëzimin e mjetit.
109. Si burim krijimi për shumën e parapaguar në vlerën 4.055 euro, subjekti ka deklaruar se janë përdorur kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat. Ndërsa si burim për shumën prej 10.500 euro, në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 13.6.2011. Referuar historikut të llogarisë së kredisë ka rezultuar se pas disbursimit shuma e akorduar nga banka është transferuar në favor të shoqërisë shitëse për likuidimin e çmimit të automjetit.
110. I pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për mbylljen e kredisë, subjekti ka deklaruar se në vitin 2013 ka likuiduar vlerën 5.000 euro nga kredia. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për likuidimin e shumës në fjalë në vitin 2013.
111. Po në këtë pyetësor, subjekti ka shpjeguar se likuidimi i plotë i kredisë është bërë në prill të vitit 2015. Ky deklaram i subjektit është konfirmuar edhe nga lëvizjet në llogarinë bankare të kredisë.
112. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dosjen e plotë të automjetit të përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>35</sup>, ku ka rezultuar se automjeti në fjalë është në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
113. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar se ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, tip “Ford Fiesta”, në vlerën 250.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 26.8.2016, në vlerën 700 euro.
114. DPSHTRR-ja<sup>36</sup> ka përcjellë dosjen e automjetit në fjalë, nga shqyrtimi i së cilës ka rezultuar se subjekti e ka përfituar me kontratën nr. \*\*\*, datë 11.5.2007, nga shtetasi A. K., në vlerën 250.000 lekë.
115. Në lidhje me shtetasin e sipërpërmendur, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të hetuara nga prokurori Armand Gurakuqi.

#### **4.1 Analizimi i burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit**

116. Komisioni ka përlllogaritur mjaftueshmërinë e burimeve financiare për krijimin e shumës 4.055 euro, të parapaguar nga subjekti për blerjen e automjetit tip “Skoda”. Nisur nga fakti

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2020.

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2022.

se në deklaratat periodike të dorëzuara nga subjekti pranë ILDKPKI-së nuk ka rezultuar deklarimi i pakësimit të kursimeve të disponuara *cash* në banesë, Komisioni ka përlloritur mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të kursyer shumën 4.055 euro, nga data 1.1.2011 deri në datën 26.5.2011.

117. Në përfundim të kësaj analize ka rezultuar se për kryerjen e investimit në këtë pasuri, subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, siç paraqitet e detajuar në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 9** – analiza financiare për blerjen e automjetit

Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2011 - 26.5.2011	422,000
Te ardhura nga paga e b/shortes 1.1.2011 - 26.5.2011	356,000
Të ardhura nga qiradhënia	-
Të ardhura nga pensioni i nënës 1.1.2011 - 26.5.2011	71,257
Shpenzime jetese 4 persona (janar - maj 2011)	(227,700)
Pagesë për blerjen e automjetit	(2,012,957)
Depozituar në llogari nga subjekti në ISP Bank	(55,320)
Kredi bankare në ISP Bank	1,452,150
<b>Rezultati në datë 26.5.2011</b>	<b>5,431</b>

118. Meqenëse në DIPP-të prej subjektit nuk është deklaruar pakësimi i kursimeve të disponuara *cash* në banesë, Komisioni ka kryer analizën financiare dhe të segmentuar, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur mund t'i rikrijonin kursimet prej 4.055 euro me burime të ligjshme financiare, nga momenti i blerjes së automjetit deri në datën 26.5.2011. Gjithsesi, edhe nëse këto kursime nuk do të konsideroheshin si të përdorura, sërish do të rezultonte një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare – duke mos rezultuar kështu problematika lidhur me deklarin e kësaj pasurie apo ligjshmërinë e burimeve financiare për krijimin e saj.

**5. Lidhur me një investim të bashkëshortes së subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.**

119. Në rubrikën e të dhënave konfidenciale të deklaratës së personit të lidhur në DIPP-në e vitit 2012 e më pas edhe në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar kontratë huaje me nr. \*\*\*, datë 18.9.2012, të lidhur me shtetasin F. Sh., për marrjen e huas në vlerën 75.000 euro. Në të njëjtën rubrikë, ajo ka deklaruar të drejta pasurore nga investimi, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit (me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\*), datë 16.10.2012, të lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.
120. Nga shqyrtimi i dy kontratave të sipërcituara<sup>37</sup> është konstatuar se znj. G. G. ka marrë një hua në shumën 75.000 euro nga z. F. Sh., me afat 5-vjeçar, deri më 5.9.2017, pa interes. Këtë shumë znj. G. e ka investuar në ndërtimin e objekteve për të cilat janë akorduar lejet e ndërtimit nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2012 dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2012, miratuar me vendimin nr. 44, datë 27.9.2011, të KRRT-së të Komunës Dajt.

<sup>37</sup> Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

121. Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit do të kontribuonte financiarisht me shumën 75.000 euro, nga e cila do të përfitonte deri në 15% të të gjithë preventivit të vlerës së ndërtimit dhe në përfundim të punimeve ajo do të përfitonte 15% të fitimit të realizuar.
122. Deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar as shlyerje të huas së cituar më sipër dhe as përfitime të realizuara nga investimi i shumës 75.000 euro.
123. Së bashku me kontratën e huadhënies nr. \*\*\*, të vitit 2012, subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës *Vetting* tri kontrata shitblerjeje pasurish të paluajtshme nga ana e shtetasit F. Sh.<sup>38</sup>, si vijon:
- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 20.12.2011, për shitjen e pasurisë së llojit “truall” me sipërfaqe 630 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 347 m<sup>2</sup>, në vlerën 16.468.286 lekë;
  - kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 20.12.2011, për shitjen e pasurisë së llojit “truall” me sipërfaqe 170 m<sup>2</sup>, në vlerën 4.443.290 lekë;
  - kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 20.12.2011, për shitjen e pasurisë së llojit “truall” me sipërfaqe 969 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 254 m<sup>2</sup>, në vlerën 27.460.353 lekë.
124. Nga sa më sipër, duket se shtetasi F. Sh. ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 75.000 euro bashkëshortes së subjektit.
125. Gjithashtu, me qëllim verifikimin e destinimit të disponibilitetit financiar, përpos burimeve të ligjshme financiare të z. Sh., Komisioni ka hetuar mbi llogaritë dhe veprimet e tij bankare deri në momentin e dhënies së huas. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni për këtë qëllim ka rezultuar se nga transaksionet e mësipërme të shitjes, z. Sh. ka arkëtuar nga z. L. L., nëpërmjet sistemit bankar, shumat 100.000 euro në datën 22.12.2010 dhe 41.834 euro në datën 9.3.2011, me përshkrimin “pagesë e pjesshme për blerje toke”. Nga këto shuma, z. Sh. ka tërhequr *cash* së paku 130.000 euro, përgjatë periudhës dhjetor 2010 – korrik 2011, të cilat duken të mjaftueshme për dhënien e shumës prej 75.000 euro, për sa kohë nuk është evidentuar ndonjë destinim investimi alternativ, nëpërmjet materialit dhe informacioneve të disponuara nga Komisioni.
126. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se jo vetëm që nuk është realizuar asnjë përfitim nga ky investim, por z. Z., me të cilin është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit, nuk ka kthyer as shumën që i është dorëzuar si financim.
127. Në vijim të veprimeve hetimore, Komisioni i ka kërkuar noteres G. Sh. të paraqiste të gjitha aktet e nënshkuara pranë zyrës së saj noteriale lidhur me këtë ndërtim, duke përfshirë këtu kontratat me pronarët e truallit, lejet e ndërtimit, kontratat e shkëmbimit, të shitjeve të mundshme etj.

<sup>38</sup> Nga DPT-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2017 dhe DRT-ja Tiranë me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2017 dhe datë 21.9.2017, është konfirmuar se shtetasi F. Sh. ka rezultuar të jetë: administrator në shoqërinë “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, me aktivitet “ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jorezidenciale”; administrator në “F. Sh.” PF, me NIPT \*\*\*, me aktivitet “punime ndërtimi”; administrator në “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, me aktivitet “tregti me shumicë dhe ndërmjetësim tregtar përveç mjeteve të transportit automobilistik”; aksioner i kompanisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*.

128. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2023, noterja ka bërë me dije se pranë zyrës së saj znj.G. ka nënshkruar vetëm kontratën e bashkëpunimit, si dhe ka përcjellë aktet e tjera: (i) kontratë investimi nr. \*\*\*, datë 7.9.2011, nënshkruar mes pronarëve të truallit N. L., U. V., R. M. e E. L., investitorëve z. Z. dhe znj. Dh., si dhe shoqërisë sipërmarrëse “\*\*\*\*” sh.p.k.; (ii) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.8.2012, e nënshkruar nga z. Z. dhe znj. Dh., si dhe shoqërisë sipërmarrëse “\*\*\*\*” sh.p.k., për “tërheqjen nga kontrata me nr. \*\*\*, datë 7.9.2011” nga znj. Dh.; (iii) marrëveshje pjesëmarrjeje në investim me nr. \*\*\* prot., datë 1.8.2012, nënshkruar mes investitorëve “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga z. Z. dhe pronarit të truallit, z. R. M., sipas vërtetimit nënshkrimit nr. \*\*\*, datë 3.10.2012; (iv) shtesë e kontratës së sipërmarrjes për caktimin e pjesëve në natyrë, me nr. \*\*\*, datë 12.9.2013, nënshkruar mes investitorëve “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe investitorëve N. L. e V. P., sipas vërtetimit nënshkrimit nr. \*\*\*, datë 3.10.2012; (v) vendim nr. \*\*\*, datë 27.9.2011, për sheshndërtim dhe vendim nr. \*\*\*, datë 27.9.2011, për leje dhe sheshndërtim.
129. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar nuk ka rezultuar që znj. G. të ketë qenë e përfshirë në aktet e hartuara pas nënshkrimit të marrëveshjes së saj me z. Z., siç janë: kontrata shtesë për investimin, marrëveshja për pjesëmarrje në investim; akti “shtesë e kontratës së sipërmarrjes për caktimin e pjesëve në natyrë” dhe as të ketë qenë e përfshirë në cilësinë e investitores në lejen e miratuar për sheshndërtimin dhe shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit në vitin 2015, në të cilën janë të cituar pronarët e truallit, shoqëria ndërtuese dhe dy investitorët e tjerë.
130. Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se gjatë viteve 2019 dhe 2020, nga ana e subjektit dhe bashkëshortes së tij ka filluar shlyerja pjesërisht e huas në fjalë. Nëpërmjet pyetësorit nr. 7, Komisioni i ka kërkuar subjektit të bënte me dije momentet e shlyerjes së huas në fjalë, si dhe burimet financiare të përdorura. Në përgjigjen e tij, subjekti ka deklaruar se nga bashkëshortja është shlyer huaja, përkatësisht: (i) shuma 1.200.000 lekë në datën 13.12.2019, nga të ardhurat nga pagat; (ii) shuma 3.500.000 lekë në datën 28.7.2020, nga të cilat 1.500.000 lekë janë siguruar nga të ardhurat nga pagat dhe 2.000.000 lekë nga një dëmshpërblim i marrë nëpërmjet aktmarrëveshjes nr. \*\*\*, datë 23.7.2020, “Për zgjidhje jashtëgjyqësisht dhe pranim të vlerës së dëmshpërblimit”; dhe (iii) shuma 36.000 euro në datën 28.7.2022, nga kredia bankare nr. \*\*\*, datë 26.7.2022.
131. Lidhur me këtë marrëdhënie, subjekti ka shtuar, në shpjegimet e tij me përgjigjet e pyetësorit nr. 7, se huaja në vlerën 75.000 euro ishte marrë për të mundësuar një bashkëpunim me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Ai ka shpjeguar se me përfitimet e realizuara nga ky bashkëpunim do të shlyente huat e marra në vitin 2009 nga vjehrra e tij dhe nga z. A. B. Sipas parashikimeve të tij, ndërtimi që do të kryhej nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. do të përfundonte brenda vitit 2015, pra 2 vite para përfundimit të afatit të huas së marrë nga z.Sh. Në këtë mënyrë do të mund të ishte shlyer huaja nga përfitimet e pritshme. Për shkak se bashkëpunimi me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dështoi, për kthimin e shumës së huas ndaj z.Sh., për rrjedhojë, subjekti mori një kredi bankare.

132. Nga dokumentacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>39</sup> ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar/verifikuar asnjë kallëzim apo procedim penal me palë shtetasin Z. Z. apo shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., përfshirë edhe ortakët e saj.
133. Komisioni ka thirrur shtetasit F. Sh.<sup>40</sup> dhe Z. Z.<sup>41</sup> për t’u pyetur në cilësinë e dëshmitarëve në datën 17.3.2023. Shkresa e nisur për z. Z. është kthyer në datën 14.3.2023 nga posta, me shënimin “objekt i pakërkuar”. Ndonëse u tentua nga sekretaria gjyqësore, po në datën 17.3.2023, të kontaktohej në të gjithë numrat e telefonit që rezultojnë nga informacionet e aksesuara, nuk u arrit që të mundësohej komunikimi me z. Z. Ndërsa z. F. Sh. u paraqit pranë Komisionit në datën dhe orën e caktuar dhe konfirmoi rrethanat e konstatuara me herët nëpërmjet dokumenteve të administruara gjatë hetimit, duke u shprehur: “(i) marrëdhënia me Armandin ka nisur në vitet 2005 - 2006 kur erdhi për të blerë apartament, e më pas krijuam miqësi, pasi ka qenë shumë korrekt me pagesat; (ii) unë kam qenë pronar i truallit ku është ndërtuar pallati ku ndodhet apartamenti i Armandit. Unë nuk kam pasur asnjë interes tek prokuroria, tek gjykata, jam inxhinier me profesion, kam qenë gjithmonë i pavarur, as unë as familja nuk kemi bërë ndonjëherë pjesë tek ata persona që kemi nevojë për gjykatën dhe prokurorinë; (iii) në vitin 2012 Armandi, bashkë me bashkëshorten, më kërkuan hua 75.000 euro, për t’i investuar tek një ndërtues që kishte ndalur punimet për shkak të vështirësive ekonomike. Unë ia dhashë pasi kam besim, por nuk mund t’i jepja me interes, për shkak të miqësisë që kemi; si dhe (iv) borxhin ma ka kthyer”.
134. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk ka logjikë ekonomike në marrjen e një huaje prej 75.000 euro për të kryer një investim në të njëjtën vlerë, ndërkohë që nuk është i qartë shkak i marrjes së tyre, pa interes, nga një ndërtues, për t’i investuar në zhvillimin e një tjetër projekti ndërtues.
135. Për më tepër, vërehet se kjo mënyrë investimi – duke përdorur mjete monetare të huazuara, në një masë shumë më të madhe sesa ato të disponuara nga vetë subjekti – është hasur në mënyrë të përsëritur, sikurse është evidentuar edhe në pasuritë e tjera të sipëranalizuara dhe, për rrjedhojë, ngrihen dyshime mbi vërtetësinë e huamarrjes në fjalë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

136. Subjekti ka shpjeguar se nga procesi i rivlerësimit është konfirmuar lidhja e kontratës nr.\*\*\*, datë 18.9.2012, e cila sipas Kodit Civil “...ka forcën e ligjit për palët”. Konfirmimi i huas nga bashkëshortja në kontratën e datës 18.9.2012 provon vërtetësinë e marrjes së huas sipas këtij dokumenti. Huaja është konfirmuar në kontratë edhe nga huadhënësi F. Sh., si dhe është konfirmuar edhe përpara Komisionit kur është pyetur në cilësinë e dëshmitarit.
137. Nga dhjetori i vitit 2010 deri në korrik të vitit 2011 z. Sh. ka tërhequr *cash* nga banka minimalisht 130.000 euro, të cilat i kishte siguruar nga shitja e pasurive. Gjithashtu provohet se z. Sh. nuk ka kryer asnjë investim me këtë sasi parash. Pra provohet në mënyrë të padiskutueshme që z. Sh. e ka disponuar vlerën 75.000 euro në datën e dhënies së huas 18.9.2012, rrethanë që konfirmon vërtetësinë e kontratës. Huaja u mor nga z. Sh. për

<sup>39</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2023.

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2023.

<sup>41</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2023.

krijimin e disa të ardhurave nga bashkëpunimi me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me qëllimin kryesor final shlyerjen e dy huave të vitit 2009.

138. Subjekti është shprehur se: *“Mes familjes së tij dhe asaj të z. Sh. ka ekzistuar një marrëdhënie që nuk është ngritur mbi baza ekonomike, por mbi dashamirësinë dhe respektin për njëri-tjetrin. Ka qenë pikërisht kjo natyrë e marrëdhënies, e cila, duke kapërcyer çdo logjikë ekonomike apo financiare, ka ndikuar tek z. Sh. për të na ndihmuar nëpërmjet huas së mësipërme. Në vitin 2007 ai ka vendosur në hipotekë shtëpinë e tij për të mundësuar marrjen e kredisë nga ana ime. Edhe ky fakt provon se marrëdhënia me z.Sh. ka funksionuar e bazuar mbi miqësinë dhe dashamirësinë, duke tejkaluar logjikën ekonomike”.*
139. Sa i takon marrjes apo jo të përfitimeve nga bashkëpunimi me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti ka shpjeguar se nga kjo marrëdhënie nuk është realizuar asnjë përfitim financiar, pavarësisht kërkimeve të realizuara tek z. Z. Për marrjen e kredisë nga shtetasit E. Ç. dhe A. V., subjekti ka sqaruar se ka vënë në hipotekë apartamentin e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”. Nisur nga fakti se shtetasit E. Ç. dhe A. V. nuk posedonin një pasuri tjetër për të vendosur në hipotekë, për të mundësuar marrjen e kredisë, nga z. Z. është kërkuar vendosja në hipotekë e një pasurie në pronësinë të subjektit dhe bashkëshortes së tij.
140. Për shkak se shitja e apartamentit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. konvenonte me të drejtat që rridhnin nga marrëveshja e bashkëpunimit e datës 16.10.2012, subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja e tij kishin rënë dakord që të vendosnin në hipotekë apartamentin e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”.
141. Vendosja e pasurisë në hipotekë u realizua edhe për shkak se bllokimi i pasurisë do të ishte i përkohshëm deri në momentin e regjistrimit të apartamentit të porositur nga shtetasit E. Ç. dhe A. V. në ZVRPP dhe në këtë moment do të bëhej zëvendësimi i hipotekës së banesës së tyre në rrugën “\*\*\*\*” me apartamentin që do të blihej nga këta shtetas.
142. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nëse do të ishin siguruar përfitime nga investimi ato do të ishin tërësisht të ligjshme dhe, për pasojë, do të ishin deklaruar para Komisionit apo ILDKPKI-së. Madje këto përfitime do të ishin përdorur për shlyerjen e huave të marra në vite dhe do të kishin shmangur marrjen e kredisë pranë “Credins Bank” për shlyerjen e huas ndaj z. Sh.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

143. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, si dhe pas analizimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me huan prej 75.000 euro, të marrë nga z.Sh., për investimin e kryer nga bashkëshortja e subjektit, Komisioni vëren se në mënyrë të përmbledhur, përgjatë hetimit administrativ, ka rezultuar sa vijon:
- Bashkëshortja e subjektit ka marrë hua nga një biznesmen për të investuar në zhvillimin e një projekti ndërtues nga një tjetër biznesmen, duke mos investuar asnjë shumë nga paratë/kursimet e veta.
  - Fakti i marrjes së një huaje në vlerën 75.000 euro, afatgjatë dhe pa interes, për ta investuar për të përfituar të ardhura, përbën një veprim, në aparence, që është kryer në



mungesë të një logjike ekonomike të ekuilibruar, midis huadhënësit dhe investitorit, privimit të huadhënësit dhe përfitimit (të pritshëm) të subjektit (investues).

- Subjekti ka hipotekuar apartamentin në pronësi të tij për të siguruar kredinë e marrë nga znj. Ç. dhe z. V. në shumën 5.000.000 lekë, për apartamentin e porositur tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në komunën Dajt, në të cilin bashkëshortja e tij kishte investuar, çka ngre dyshime mbi deklaratimet e tij mbi ecurinë negative të investimit të kryer dhe për mospërfitimin e asnjë shume nga ky investim – ndonëse z. Sh. në dëshminë e tij ka pohuar të kundërtën (me sa dijeni ai kishte).
- Subjekti ka investuar në mënyrë të përsëritur, duke përdorur mjete monetare të huazuara, në një masë shumë më të madhe sesa ato të disponuara nga vetë ai, madje në këtë rast investimi është kryer totalisht me burim financiar të përfituar nga një hua. Për rrjedhojë, Komisioni ka ngritur dyshime mbi vërtetësinë e huamarrjes në fjalë, duke i konsideruar si të vetë subjektit shumat e investuara nga bashkëshortja e subjektit në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

144. Nga një vlerësim i përgjithshëm i dinamikës, rrethanave, deklaratimeve, shpjegimeve dhe dokumenteve të administruara në lidhje me këtë marrëdhënie juridiko-financiare të krijuar nga bashkëshortja (*de jure*) dhe nga subjekti (*de facto*), në marrëdhëniet respektive me z.F. Sh. (huamarrje) dhe me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. (investimi në shoqëri), në vlerësim të Komisionit vërehen një sërë faktesh që, të ndërthurura mes tyre, çojnë në një kombinim shkak-pasojë, që në konkluzion evidenton cenimin e besimit të publikut dhe aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, Komisioni çmon se:

- a. Investimi i kryer në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. mbart tiparet që konkretizohen në ortakëri – ekspozim ndaj risqeve të biznesit, në këmbim të një përfitimi në raport me përfitimet e shoqërisë. Ky kontekst dhe kjo marrëdhënie rezultojnë jo në përputhje me pozicionin e magistratit dhe cenojnë besimin e publikut.
- b. Fakti i pretenduar nga subjekti se ky investim ka qenë një dështim, nuk rezulton i provuar, pasi – ndonëse mund të ketë pasur vonesa në realizimin e ndërtimeve të projektuara dhe/ose në arkëtimin e të gjitha të ardhurave të pritshme nga shitja e tyre – kjo nuk do të thotë se kjo rrethanë nuk do të verifikohet më tej. Përkundrazi, fakti që midis bashkëshortes së subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk ka pasur një akt zyrtar që të revokonte apo ndryshonte marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur më herët mes tyre, do të thotë që kjo e fundit është ende në fuqi. Prodhimi i efekteve të pritshme, sipas marrëveshjes në fjalë (përfitimi i 15% të fitimit që shoqëria do të realizojë nga ky investim), mund të ketë (pasur) shtyrje në kohë, por në fund e sipër detyrimi që mbart shoqëria ndaj familjes së subjektit mbetet gjithmonë i ekzekutueshëm, pikërisht ndaj shoqërisë – (pavarësisht problematikave personale të ortakëve apo administratorëve të përkohshëm).
- c. Ka rezultuar jo bindës pretendimi se investimi i kryer është financuar me bujari nga z. Sh. – nëpërmjet huadhënies prej 75.000 euro – pasi ky i fundit, përpos disponibilitetit financiar të përkohshëm, nuk mund të privonte biznesin e vet për një kohë relativisht të gjatë (5-10 vjet), nga një shumë e konsiderueshme monetare, pa përfituar asnjë interes

(madje duke i paguar interesa bankës për marrjen, më pas, të kredive për të investuar në bizneset e veta).

145. Nisur nga faktet e rezultuara gjatë hetimit si dhe shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti rivleresimit, krijohet bindja se subjekti rivlerësimit, nëpërmjetë bashkëshortes, ka lidhur një Marrëveshje Investimi e cila ka patur për qëllim përfitimin në një vlerë të konsiderueshme të disa pasurive të paluajtshme (15% e fitimit) dhe se vlera e investuar ka qënë tërësisht një huamarrje pa interes. Kësisoj kjo marrdhënie nuk duket bindëse në vetvete pasi të gjitha rrethanat krijojnë dyshime se deklarimi mbi burimin e investimit nuk pasqyron realitetin dhe mbart shumë pikpyetje, të pashpjeguara nga subjekti. Mënyra se si dhe kur kjo huadhënie është shlyer, gjithashtu, ndikon në krijimin e këtij perceptimi. Vlen të theksohet se vetë marrveshja e investimit në fjalë, me shoqërinë përkatëse, është një verprim juridik që të krijojë bindjen se vijon të jetë në fuqi, dhe mund të prodhojë efektet e parashikuara në çdo moment – pas zgjidhjes së problematikave mes ortakëve apo me të tretë, për sa kohë detyrimi i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. ndaj bashkëshortes së subjektit nuk është shuar dhe as është modifikuar – përpos vonesave në kohë. Ng ana tjetër edhe nga bashkëshortja apo nga vetë subjekti nuk është kryer asnjë përpjekje ndër vite për anulimin apo revokimin e saj, dhe as ndonjë nismë ligjore prej tyre për përfitimin e të drejtave të dakortësuara apo për riparimin e dëmeve të pretenduara nga mospërmbushja e detyrimeve nga ana e shoqërisë në fjalë. Komisioni vëren se, pavarësisht problematikave kalimtare të hasura nga pronari/administratori/ortaku/ët e shoqërisë investuese, marrdhënia e bashkëshortes së subjektit me këtë shoqërinë është në fuqi dhe se ata si bashkëshortë do të mund të gëzojnë pasuri të paluajtshme të konsiderueshme në të ardhmën e cila vetë zanafillën e ka të mbi marrdhënie të dyshimta. Po ashtu e vlerësuar edhe në tërësinë e saj, fakti se shtetasit F. Sh. (huadhënësi) dhe Z. Z. (investitori) kanë patur hetime dhe procese penale, në Prokurorinë ku vetë subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e prokurorit, ngre dyshime të arsyeshme se vetë kjo marrdhënie nuk duhet të vendosej qysh prej fillimit. Po ashtu duke vlerësuar historikun për të ardhurat dhe shpenzimet, apo lidhur me krijimin e pasurive nga subjekti i rivlerësimit, mundësitë e tij financiare ndër vite, analiza financiare e Komisionit, rezulton se kjo marrdhënie huadhëniesh të vazhduara nga subjekti është një qasje e tij për të shtuar pasuritë, të cilat në fakt ngrenë dyshime apo krijojnë perceptimin se janë fiktive dhe kanë për qëllim shtimin e pasurive të vetë subjektit megjithëse ai nuk ka realisht të ardhura për të kryer ato. E gjithë sjellja e subjektit të rivlerësimit për kthimin e huasë ndaj shtetasit F. Sh. daton pas deklaratës veting, dhe pikërisht në periudhën e kryerjes së verifikimeve nga Komisioni, duke qënë kështu jo në harmoni me angazhimet e marra nga personi i lidhur (bashkëshortja) në marrveshjen e huasë. Po ashtu ata kanë deklaruar në deklaratën vetting një gjendje *cash* që e disponin në banesë, megjithëse ndodheshin në disa situata huamarrjeje ende të pashlyera nga vitet më parë.
146. Nisur nga sa më sipër, në konkluzion të vlerësimit të kësaj marrëdhënieje juridiko-financiare, Komisioni çmon se sjellja e subjektit, dinamika në kohë e vetë marrëdhënies *de qua*, si dhe kushtet dhe rrethanat në të cilat është krijuar dhe zhvilluar kjo marrëdhënie interesi, krijon bindjen se e gjithë kjo situatë është krijuar në mënyrë artificiale, për të evituar verifikimin e burimeve reale, duke tentuar fshehjen e gjurmëve të investimit të vertetë. Në këto kushte, pavarësisht se huadhënësi, z. Sh., ka patur aftësi huadhënese, kjo

nuk i justifikon veprimet, mosveprimet dhe pritshmëritë e mëtejshme të subjektit të rivlerësimit, e për rrjedhojë Komisioni vlerëson se z. Armand Gurakuqi, ndodhet në kushte te nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutes, dhe se ai me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut e për pasojë, në këtë rast duhet të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me pasojë shkarkimin e subjektit nga detyra.

## **6. Llogari bankare në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të**

147. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, kanë pasur disa llogari bankare në bankat e nivelit të dytë, ndonëse me gjendje minimale<sup>42</sup>. Gjithashtu, në emër të djalit të subjektit ka qenë një llogari depozite pranë OTP Bank (ish “Societe Generale Albania”), me gjendje 150.278 lekë.
148. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej subjektit, bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, ka rezultuar depozitimi i lëvizjeve të këtyre llogarive, nga shqyrtimi i të cilave nuk ka rezultuar ndonjë problematikë lidhur me burimin e krijimit.
149. Nga sa më sipër, ka rezultuar se ndonëse nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimet e krijimit të gjendjeve në llogaritë bankare, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjet e disponuara në llogaritë e tij bankare dhe të personave të lidhur me të.
150. Referuar përcaktimit ligjor të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas të cilit: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*”.
151. Megjithatë, ndonëse subjekti nuk i është përmbajtur përcaktimeve ligjore të sipërcituara, fakti që nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se llogaritë në fjalë kanë qenë me gjendje minimale, e klasifikon këtë mosdeklarim në nivel pasaktësie, për sa kohë që nuk ndikon në rezultatin e analizës financiare.

## **7. Gjendje cash në shumën 1.100.000 lekë**

152. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje të disponuar *cash* në banesë, në masën 1.100.000 lekë.

---

<sup>42</sup> Llogari e pagës së subjektit në “Credins Bank”, me gjendje 350 lekë; llogari e kartës Visa në “Credins Bank”, me gjendje 9.627 lekë; llogari në emër të vajzës së subjektit në “Credins Bank”, me gjendje 5.000 lekë; llogari e subjektit në “Raiffeisen Bank”, me gjendje 202 euro; llogari e vajzës së subjektit në ABI Bank, me gjendje 5.000 lekë; llogari depozite në emër të subjektit në ABI Bank, me gjendje 38.75 euro; llogari e bashkëshortes në BKT, me gjendje 15.925 lekë; dhe llogari rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”, me gjendje 6.892 lekë.

153. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit ndër vite, ka rezultuar se prej tij janë deklaruar kursime *cash* ndër vite, me përshkrimet si vijon:
- në DIPP-në e vitit 2003 ka deklaruar kursime cash nga të ardhurat në vite, shumën 400.000 lekë, të depozituara më pas në shkurt të vitit 2004 në NBG Bank;*
  - në DIPP-në e vitit 2004 ka deklaruar kursime cash në shumën 400.000 lekë, me burim dhuratë nga vëllai në Greqi;*
  - në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar shtesë 270.000 lekë, por pa përcaktuar llojin e pasurisë, nëse janë kursime në cash apo në ndonjë llogari bankare, por duke qenë se në llogaritë bankare nuk ka rezultuar ndonjë shtesë me këtë vlerë, Komisioni e ka konsideruar shtim të kursimeve të disponuara cash në banesë;*
  - në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar gjendje cash në vlerën 1.000.000 lekë;*
  - në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar shtesë të kursimeve cash në vlerën 300.000 lekë, nga të ardhurat familjare;*
154. Nisur nga sa më sipër deklaruar prej subjektit të rivlerësimit ndër vite, si dhe kërkesave ligjore mbi mënyrën e deklarimit, Komisioni ka kryer analizën financiare për shtesat, si në vijim: në vitin 2004 në shumën 400.000 lekë; në vitin 2006 në shumën 270.000 lekë; në vitin 2015 në shumën 330.000 lekë; dhe në vitin 2016 në shumën 300.000 lekë.
155. Sa i përket shumës prej 400.000 lekësh, të krijuar në vitin 2004, me burim dhurimet e vëllait nga të ardhurat e këtij të fundit nga emigracioni në Greqi, në vijim të analizës së kryer në pikën 1.1 të këtij vendimi ka rezultuar se mund të dhurohej me burime të ligjshme financiare.
156. Ndërsa, për shumat e tjera, nga analiza financiare ka rezultuar se për krijimin e shtesës së kursimeve prej 270.000 lekësh në vitin 2006, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej -151.348 lekësh. Ndërsa, për shtesat e viteve 2015 dhe 2016, nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për t'i krijuar ato, me burime të ligjshme.
157. Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se:
- *Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -151.348 lekësh në vitin 2006, për të kursyer shumën 270.000 lekë gjatë atij viti.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

158. Lidhur me këtë konkluzion, subjekti është shprehur se kjo mungesë ka rezultuar pasi në këtë vit është konsideruar shtimi i kursimeve *cash* me vlerën 270.000 lekë, ndërkohë që në DIPP-në e atij viti nuk ka specifikuar që kjo shumë është *cash*, duke pretenduar se shtesa e deklaruar ka qenë në llogarinë e tij bankare, jo në fund të vitit, por në momentin e deklarimit.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

159. Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të pagës nuk ka rezultuar e shtuar vlera e pretenduar nga subjekti, as në fund të vitit 2006 dhe as përgjatë muajve të parë të vitit 2007. Në këto kushte, pretendimi i subjektit është konsideruar i pabazuar.

## 8. Konstatime në lidhje me pasuri të tjera

160. Nga verifikimi i kryer në sistemin *online* multifunksional të ASHK-së për institucionet, ka rezultuar se në emër të subjektit të rivlerësimit figurojnë të regjistruara<sup>43</sup>, përveç atyre të trajtuara në këtë relacion, edhe pasuritë si vijon:
- apartament me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 120.2 m<sup>2</sup>, me vlerë 84.000 euro, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 7.7.2022;
  - garazh me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 19.2 m<sup>2</sup>, me vlerë 1.126.000 lekë, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 20.4.2022;
  - garazh me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 19.2 m<sup>2</sup>, me vlerë 1.126.000 lekë, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 20.4.2022;
  - depo me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 3.2 m<sup>2</sup>, me vlerë 180.000 lekë, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 20.4.2022.
161. Këto pasuri janë blerë nga subjekti tek shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka bërë me dije se pasuria e llojit “apartament” është porositur nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 12.1.2021 dhe çmimi është likuiduar në llogarinë bankare të shtetasit F. Sh. (pronar i truallit), si në vijim: (i) 700.000 lekë në datën 15.10.2021; (ii) 20.000 euro në datën 15.10.2021; (iii) 30.000 euro në datën 27.10.2021; (iv) 22.000 euro në datën 2.11.2021; dhe (v) 6.166.67 euro në datën 28.7.2022.
162. Ndërsa, pasuritë e tjera janë porositur me kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 25.10.2021 dhe janë likuiduar në llogaritë bankare të shoqërisë, si në vijim: (i) 100.000 lekë në datën 26.10.2021; (ii) 1.900.000 lekë në datën 2.12.2021; dhe (iii) 432.000 lekë në datën 12.4.2022.
163. Subjekti i rivlerësimit është ftuar nëpërmjet pyetësorit nr. 4 për të bërë me dije mbi burimet e përdorura për blerjet e pasurive të sipërcituara. Në përgjigje të tij, subjekti është shprehur se për kryerjen e pagesave të mësipërme, prej tij janë përdorur të ardhurat nga pagat e viteve 2021 dhe 2022, të ardhurat nga shitja e apartamentit të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” në vitin 2021, të ardhurat nga një dëmshpërblim të përfituar në vitin 2020, si dhe dy kredi bankare të marra në vitet 2021 dhe 2022.
164. Në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti ka bërë me dije se z. Sh. ka qenë pronari i truallit mbi të cilin është ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. objekti në të cilin ndodhen pasuritë e mësipërme. Apartamenti është blerë nga z. Sh. prej pjesës së përfituar prej tij në këmbim të sipërfaqes së truallit, ndërsa dy garazhet dhe depoja janë porositur te kjo shoqëri, ku z.Sh. është ortak dhe administrator. Në kontratën e shitjes kanë nënshkruar edhe palët e tjera (zhvillues dhe ndërtues) të të gjithë objektit, për shkak se objekti fillimisht është regjistruar në emër të të gjithë subjekteve që kanë marrë pjesë në ndërtim. Sa i takon mënyrës së përfitimit nga z. Sh., i pronësisë së truallit, subjekti ka deklaruar se nuk disponon informacion të saktë. Ai ka shpjeguar se nga bisedat joformale me z. Sh. ka mësuar se ai

<sup>43</sup> Këto pasuri përmenden edhe në denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2022, të trajtuar në rubrikën e denoncimeve.

ka përfituar pronësinë mbi truallin në fillim të viteve '90, pasi ka privatizuar një ish-ndërmarrje shtetërore, në të cilën ka pasur funksion drejtues. Ndërmarrja shtetërore e privatizuar nga z. Sh. ka pasur një shtrirje duke filluar nga rruga “\*\*\*\*” deri në fund të rrugës aktuale “\*\*\*\*”. Sipërfaqja e ndërmarrjes përfshinte të gjithë truallin mbi të cilin është ndërtuar pallati ku është porositur apartamenti në vitin 2005, ashtu edhe pallati ku ndodhen pasuritë e porositura në vitin 2021.

165. Pasi është paraqitur kërkesë nga Komisioni, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar hetime apo procedime penale ndaj shoqërisë dhe as në emër të ortakut të saj A. R.<sup>44</sup>.
166. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ, SPAK ka bërë me dije se shtetasi A. R. nuk ka rezultuar i proceduar apo i hetuar nga ky institucion.
167. Nisur nga fakti që këto pasuri janë blerë pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, si dhe nuk ka *indicie* për përdorim të kursimeve të disponuara më herët përpara dorëzimit të kësaj të fundit, Komisioni nuk shikon arsye për të hetuar më tej lidhur me burimet financiare të përdorura për blerjen e tyre.

### **9. Lidhur me udhëtimet e subjektit jashtë shtetit**

168. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësin nr. 1 udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë prej tij dhe anëtarëve të familjes, si dhe ka paraqitur pasaportat aktuale. I pyetur nga Komisioni, nëpërmjet pyetësit nr. 7, për të paraqitur pasaportat e mëparshme, subjekti ka bërë me dije se atë e ka dorëzuar pranë kompanisë “\*\*\*\*”, në kuadër të plotësimit të procedurave të pajisjes me pasaportën e re dhe e ka vlerësuar të panevojshme ruajtjen e pasaportës së mëparshme. Edhe sa i takon pasaportave të mëparshme të bashkëshortes dhe fëmijëve, subjekti ka deklaruar se këto dokumente nuk disponohen prej tij.
169. Përpos udhëtimeve turistike, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar disa udhëtime të kryera prej tij në kuadër të detyrës, për të cilat janë mbuluar shpenzimet nga organizatorët e trajnimeve apo institucioni punëdhënës. Mes tyre, subjekti ka deklaruar tri udhëtime me destinacion SHBA-të, për të cilat ka paraqitur një *email* nga përfaqësuesit e O.-it, të cilët kanë konfirmuar mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të qëndrimit përgjatë kohëzgjatjes së trajnimeve.
170. Nisur nga fakti që për dy prej këtyre udhëtimeve, në *email*-in e paraqitur nga subjekti nuk ishin të përcaktuara datat e trajnimit, Komisioni, nëpërmjet pyetësorëve nr. 6 dhe nr. 7, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bënte me dije mbi kohëzgjatjen e trajnimeve, kostot e udhëtimit dhe qëndrimit të tyre, si dhe nga kush janë përballuar ato. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, ai nuk mund të saktësojë sa kanë qenë ditët e trajnimeve, por ka paraqitur një deklaratë të datës 2.2.2023, të lëshuar nga motra e tij në SHBA, e cila ka deklaruar se z. Gurakuqi ka qëndruar në banesën e saj në Miami, Florida, mesatarisht rreth 1 javë në vitin 2009, rreth 1 javë në vitin 2010 dhe rreth 1 javë në vitin 2012. Ajo ka shtuar se përgjatë këtyre periudhave, ajo ka mbuluar shpenzimet e qëndrimit të subjektit. Përveç tri rasteve të mësipërme, subjekti ka

---

<sup>44</sup> Për administratorin e kësaj shoqërie, shtetasin F. Sh., është bërë sqarimi përkatës në f. 6 të këtij vendimi.

deklaruar se ai, nëna, bashkëshortja apo fëmijët e tij nuk ka udhëtuar në asnjë rast drejt SHBA-së.

171. Në analizën financiare, shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në të dhënat në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes së tij, si dhe deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, në përputhje me metodologjinë e Kolegjit, në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019. Për udhëtimet në SHBA, për ditët e qëndrimit tek motra e subjektit janë përlllogaritur shpenzimet në masën 5 USD/dita. Të gjitha udhëtimet e tjera turistike janë përlllogaritur me koston prej 50 euro/dita, sipas praktikave standarde të aplikuara deri më tani.
172. Nga verifikimi i kryer *online* në sistemin informatik të AMF-së, referuar të dhënave nga sistemi TIMS, nuk kanë rezultuar automjete në përdorim nga subjekti i rivlerësimit. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se në datën 17.10.2021 subjekti ka udhëtuar jashtë Shqipërisë me anë të një automjeti me targa \*\*\*, i cili figuron i regjistruar në emër të shtetasit Y. S.<sup>45</sup>. I pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë shtetas, subjekti ka deklaruar se në datën 17.10.2021 është kthyer nga Maqedonia e Veriut nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Thanës me automjetin e tij me targa \*\*\*. Në atë shtet ka kaluar në datën 15.10.2021, pra 2 ditë më parë, përsëri me mjetin e tij me targën e mësipërme. Për rrjedhojë, duket se targa \*\*\* është një lapsus, ku numri i targës “\*\*\*\*” është shkruar gabimisht “\*\*\*\*” përgjatë procesit të regjistrimit të të dhënave në pikën kufitare.
173. Gjithashtu, në vijim të kërkesave të nisura nga Komisioni, SPAK<sup>46</sup> ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të pronarëve të automjeteve me të cilat ka udhëtuar subjekti dhe as në emër të bashkudhëtarëve të tij.

### **REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE**

174. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.  
Në këtë analizë, janë paraqitur:
175. Pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit, me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës të kontratave të shitblerjeve.

---

<sup>45</sup> Në lidhje me këtë shtetas, nga prokuroria dhe SPAK-u është bërë me dije se nuk kanë rezultuar procedime penale ndaj tij.

<sup>46</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2022.

176. Të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur deklaratës *Vetting*.
177. Shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i.
178. Shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet për licencën e avokatit janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së.
179. Shpenzimet e arsimit të fëmijëve janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, konfirmuar me shkresat e dërguara nga institucioni arsimor “\*\*\*”, me nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2022.
180. Shpenzimet e arredimit të banesave janë konsideruar në vitet përkatëse të marrjes në dorëzim të apartamenteve, sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorëve.
181. Detyrimet përfshijnë gjendjen në fund të çdo viti të detyrimeve të subjektit ndaj bankave të nivelit të dytë dhe palëve të treta. Likuidimet e kryera në vijim të detyrimeve ndaj bankave, ku janë përfshirë në total likuidimi i interesave dhe principalit së bashku, bazuar në lëvizjet bankare bashkëngjitur praktikës nga “Intesa Sanpaolo Bank”, janë shënuar tek shpenzimet e kredive.
182. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të dhe anëtarëve të familjes.
183. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
184. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, moment në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në masën -2.974.499 lekë, për të cilin i ka kaluar subjektit barrën e provës.
185. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi në raport me analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe pas pranimin pjesërisht të tyre – të cilat janë trajtuar më herët në analizën e pasurive – arriti në konkluzionin se përgjatë periudhës 2003 – 2016, subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -2.693.552 lekë, siç është detajuar në tabelën e mëposhtme.



## Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>106,413</b>	<b>988,197</b>	<b>973,056</b>	<b>584,416</b>	<b>2,643,979</b>	<b>-56,472</b>	<b>4,327,061</b>	<b>231,405</b>	<b>2,079,673</b>	<b>10,508,900</b>	<b>-122,469</b>	<b>33,183</b>	<b>303,499</b>	<b>338,230</b>
Apartament Rr. J. M., Tirane			2,509,619		2,418,200									
Automjet tip Ford					250,000									
Apartament Rr. Q. S., Tirane							4,000,000	600,000						
Automjet tip Skoda									2,012,957					
Investuar në ndërtim ***										10,479,000				
Ndryshim likuiditeteve cash	-290,965	0	0	270,000	0	0	0	0	0	0	0	0	330,000	300,000
Ndryshim likuiditeteve ne llogarite bankare	397,377	988,197	-1,536,563	314,416	-24,221	-56,472	327,061	-368,595	66,717	29,900	-122,469	33,183	-26,501	38,230
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>962,756</b>	<b>1,950,953</b>	<b>414,389</b>	<b>998,806</b>	<b>974,585</b>	<b>918,113</b>	<b>1,245,174</b>	<b>876,578</b>	<b>943,295</b>	<b>973,194</b>	<b>850,725</b>	<b>883,909</b>	<b>1,187,408</b>	<b>1,525,637</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,418,200</b>	<b>0</b>	<b>2,000,000</b>	<b>0</b>	<b>1,452,150</b>	<b>10,479,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Kredi bankare per blerje apartamenti					2,418,200									
Kredi bankare per blerje automjeti									1,452,150					
Hua nga shtetasi F. Sh.										10,479,000				
Hua nga shtetasi H. H.							0							
Hua nga shtetasi A. B.							2,000,000							
<b>PASURI NETO</b>	<b>106,413</b>	<b>988,197</b>	<b>973,056</b>	<b>584,416</b>	<b>225,779</b>	<b>-56,472</b>	<b>2,327,061</b>	<b>231,405</b>	<b>627,523</b>	<b>29,900</b>	<b>-122,469</b>	<b>33,183</b>	<b>303,499</b>	<b>338,230</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1,207,438</b>	<b>2,063,916</b>	<b>952,093</b>	<b>1,122,146</b>	<b>1,343,181</b>	<b>2,003,188</b>	<b>2,169,929</b>	<b>2,032,915</b>	<b>2,260,365</b>	<b>1,764,805</b>	<b>1,779,725</b>	<b>2,415,383</b>	<b>2,507,558</b>	<b>2,796,460</b>
Te ardhura te subjektit	644,649	790,380	813,249	848,369	873,148	1,250,494	1,134,322	1,139,677	1,128,134	1,154,204	1,241,882	1,448,955	1,410,814	1,459,816
Te ardhura nga qiradhenia													198,000	264,000
Te ardhura nga interesat bankare	1,530	22,299	15,994											
Te ardhura te bashkeshortes		154,056	11,544	149,106	331,094	605,994	776,964	728,579	845,521	432,500	353,978	776,967	706,065	879,748
Te ardhura te nenes	88,865	101,503	111,306	124,671	138,939	146,700	164,663	164,659	171,017	178,101	183,865	189,461	192,679	192,896
Dhurate nga familjaret	472,394	995,678					93,980		115,693					
<b>SHPENZIME</b>	<b>561,592</b>	<b>605,456</b>	<b>588,228</b>	<b>769,485</b>	<b>871,913</b>	<b>1,868,224</b>	<b>1,352,921</b>	<b>2,144,063</b>	<b>849,176</b>	<b>1,049,111</b>	<b>1,799,582</b>	<b>1,458,842</b>	<b>1,958,953</b>	<b>1,991,362</b>
Shpenzime jetese	281,592	375,456	438,228	328,671	430,810	546,480	546,480	546,480	580,635	705,120	705,120	1,099,990	1,121,380	1,175,460
Shpenzime qiraje	180,000	180,000	150,000	180,000	90,000									
Shpenzim për licencën e avokatisë							100,000							
Shpenzime udhëtimi				160,814	0	80,997	328,382	5,772	43,837	4,263	65,015	245,328	388,521	616,202
Shpenzime arsimimi të fëmijëve													170,000	170,000
Shpenzime arredimi	100,000	50,000		100,000	200,000		200,000							
Shpenzime për tatimin e qirasë														29,700
Shpenzime kredite					151,104	1,240,747	178,059	1,591,811	224,704	339,728	1,029,447	113,524	279,052	
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>539,434</b>	<b>470,263</b>	<b>-609,191</b>	<b>-231,755</b>	<b>245,488</b>	<b>191,436</b>	<b>-1,510,053</b>	<b>-342,552</b>	<b>783,666</b>	<b>685,795</b>	<b>102,612</b>	<b>923,358</b>	<b>245,106</b>	<b>466,868</b>
Gjendje cash ne banese	400,000	400,000	400,000	670,000	670,000	670,000	670,000	670,000	670,000	670,000	670,000	670,000	1,000,000	1,300,000
Gjendje ne llogarite bankare	562,756	1,550,953	14,389	328,806	304,585	248,113	575,174	206,578	273,295	303,194	180,725	213,909	187,408	225,637
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>			<b>-2,693,552</b>											

186. Në përfundim, trupi gjykues – bazuar në konkluzionet e mësipërme, ku ka rezultuar një pamundësi financiare totale prej 2.693.552 lekësh – vlerëson se subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, gerrat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, situatë e cila, krahas problematikave të tjera të konstatuara në deklaratimet në vite të subjektit, ndonëse jo të cituara në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 33, pika 5 e të ligjit nr. 84/2016, çojnë në përfundimin se subjekti ka dështuar të provojë bindshëm pasuritë e tij në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, subjekti ka krijuar në vijimësi pasuritë e tij duke përdorur në masën më të madhe burimet e personave të tretë dhe vetëm pjesërisht dhe minimalisht ka përdorur kursimet e tij. Në këto kushte subjekti gjendet para situatës së parashikuar prej pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, e për pasojë duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

187. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar – AKSIK, (ish Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të

cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi.

188. Me shkresën e datës 22.4.2022, organet ligjzbatuese i kanë bërë me dije Komisionit se nga verifikimet e kryera nuk janë disponuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit.
189. Në vijim të kërkesës së Komisionit, datë 17.6.2022, për një përditësim dhe deklasifikim të raportit të tyre, AKSIK, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2022, ka përcjellë raportin e sipërcituar, të deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së.
190. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ai ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) rezultoi se ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) rezultoi se nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

191. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
192. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
193. Raporti nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, i përcjellë nga KLP-ja, është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.
194. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në arkivin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi në periudhën janar 2007 e në vazhdim ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
195. Për sa i përket të dhënave statistikore, prokurori Armand Gurakuqi, në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka drejtuar dhe

kontrolluar hetimin, si dhe ka përfaqësuar akuzën në gjykim për 354 çështje penale gjatë 3 viteve të fundit të ushtrimit të detyrës.

196. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2014 – 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Armand Gurakuqi, nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Nga vlerësimet e punës së subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, ka rezultuar se subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë dhe etikën profesionale, të treguar prej tij.
197. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë rezultoi se për subjektin e rivlerësimit Armand Gurakuqi janë regjistruar 3 ankesa, të cilat janë trajtuar duke u kthyer përgjigje ankuesve dhe se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar një kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kallëzime për të cilin është marrë vendim për mosfillimin nga kjo Prokurori.
198. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak të dokumentuar, ku të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.
199. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, përgjithësisht nuk vërejtí problematika të natyrës procedurale dhe as mangësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

### **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

200. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike, të administruara për këtë qëllim.
201. Përgjatë hetimit administrativ, Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\*, datë 7.10.2020, ka konfirmuar se veç tri ankesave ndaj prokurorit Armand Gurakuqi, të trajtuara edhe në raportin e KLP-së, ka rezultuar edhe praktika nr. \*\*\*, viti 2020, nga shtetasja D.L., e cila i është dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>47</sup> për shqyrtim ILD-së në lidhje me etikën e prokurorit.
202. Komisioni ka administruar nga ILD-ja<sup>48</sup> praktikën që i përket ankesës së shtetasës D. L.. Në përgjigjen e kthyer për Komisionin, ILD-ja<sup>49</sup> ka bërë me dije se me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2022, ankesa në fjalë është arkivuar. Nga shqyrtimi i këtij vendimi, ndër të tjera, ka rezultuar e parashtruar se, megjithëse ankuesja ka ngritur pretendime lidhur me

<sup>47</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2020.

<sup>48</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2022.

<sup>49</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022.

etikën e prokurorit Armand Gurakuqi, ajo nuk ka referuar të dhëna mbi kohën dhe rrethanat e faktit që pretendohet të ketë ndodhur, për rrjedhojë ankesa nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 120/1/a/b të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe për këtë arsye është arkivuar.

203. Në përfundim, Komisioni çmon se nuk janë konstatuar shkelje konkrete procedurale apo dobësi në arsyetimin e vendimit nga subjekti, të cilat mund të kualifikoheshin si mangësi në aftësitë profesionale të tij.

### DENONCIME NGA PUBLIKU

204. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 18 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të materialeve përkatëse lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për vlerësime më të thella lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar se nga përmbajtja e një pjese të tyre nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme të subjektit apo *indicie*, mbi të cilat të mund të kryhej ndonjë hap hetimor i mëtejshëm. Ndërsa mbi disa të tjerë janë kryer hetime të thelluara dhe janë administruar dokumente dhe informacione shtesë, siç janë trajtuar në vijim:

#### 1. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2017, nga shtetasi V. Ç.

205. Denoncuesi ka pretenduar se i është marrë në mënyrë të padrejtë, nëpërmjet falsifikimit, një sipërfaqe toke mbi 20.000 m<sup>2</sup> dhe se prokurori i çështjes nuk ka kryer hetim dhe, për pasojë, sipas tij ka shpërdoruar detyrën.
206. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar<sup>50</sup> nuk ka rezultuar ndonjë akt/vendimmarrje e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, ka rezultuar se në cilësinë e përfaqësuesit të prokurorisë kanë qenë prokurorë të tjerë dhe jo prokurori Armand Gurakuqi.
207. Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se çështja objekt denoncimi ka një historik në prokurori dhe në gjykatat e të dyja shkallëve, që daton që nga viti 2005. Sikurse është konstatuar edhe nga aktet e tjera të prokurorisë dhe gjykatave, në vendimmarrjet e tyre kanë rrëzuar pretendimet e shtetasit V. Ç. Po ashtu, edhe vendimi i datës 12.11.2014, “Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2012”, i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi të cilin ngrihen pretendimet e denoncuesit, ka rezultuar i mbështetur dhe i lënë në fuqi në të dyja shkallët e gjyqësorit. Konkretisht, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.10.2015, po ashtu edhe nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.2.2017, të cilat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore, duke arsyetuar ndër të tjera se nga tërësia e akteve shkresore të administruara nga Prokuroria, arsyetimi ligjor i faktit penal, si dhe kryerja e hetimeve të

---

<sup>50</sup> Pasi është kontaktuar nga zyra e denoncimeve, denoncuesi ka paraqitur dokumentacionin plotësues me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2022.

plota nga ana e saj, është konkluduar mungesa e elementeve të veprës penale. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit.

## **2. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2022 dhe nr. \*\*\* , datë 1.2.2023 nga shtetasi V.Ç.**

208. Denoncuesi ka ngritur pretendime për disa gjyqtarë e prokurorë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit Armand Gurakuqi, duke i akuzuar për korrupsion dhe shpërdorim detyre dhe vendim të padrejtë.
209. Komisioni vëren se pretendimet e denoncuesit kanë qenë deklarative dhe nuk referonin prova apo shkelje procedurale konkrete në lidhje me prokurorin Gurakuqi. Ndërsa, për sa i përket pretendimit të denoncuesit për vendimmarrje të padrejtë, Komisioni vlerëson se pretendime të kësaj natyre nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni. Në këto kushte, nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit.

## **3. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2022, nga shtetasi G. S.**

210. Denoncuesi nuk ka ngritur pretendime për veprimtarinë profesionale të subjektit, por mbi pasuri të mundshme të tij të padeklaruara, duke e akuzuar prokurorin Armand Gurakuqi për korrupsion. Ai ka parashtruar se prokurori ka disa apartamente në pronësi të tij, por të paregjistruar. Konkretisht, denoncuesi është shprehur se z. Armand Gurakuqi disponon një apartament dhe një garazh në pallatin “\*\*\*”, në rrugën “\*\*\*”, një apartament dhe një garazh në kompleksin “\*\*\*”, po në rrugën “\*\*\*”, në Tiranë, si dhe një apartament në Gj.L., në Durrës. Këto pasuri, sipas denoncuesit, mund të jenë përfituar në emër të anëtarëve të familjes së subjektit, të cilët kanë ndryshuar të dhënat e tyre në gjendjen civile.
211. Referuar të dhënave të parashtruara nga denoncuesi, duket se pasuritë e ndodhura në rrugën “\*\*\*”, përkohë me adresën e pasurisë që subjekti vetë ka deklaruar se ka në pronësi, si dhe pasuritë e krijuara prej tij gjatë vitit 2022.
212. Për sa i përket ekzistencës së mundshme të ndonjë pasurie të subjektit, të ndodhur në Gj.L., Durrës, sikurse ka referuar denoncuesi, nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni (informacionet dhe dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja, RNSH-ja, FSHU-ja, UKT-ja, bankat e nivelit të dytë, etj.), si dhe nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së për institucionet, nuk ka rezultuar porositja/blerja/kryerja e ndonjë pagese për pasuri të mundshme, në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, në këtë adresë.
213. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti dhe personat e lidhur kanë ndryshuar të dhënat e tyre në gjendjen civile, gjatë hetimit administrativ nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile<sup>51</sup> është bërë me dije se këta shtetas nuk kanë pasur ndryshime ndër vite në përbërësit e gjendjes civile.
214. Nga sa më sipër, ndonëse u ndërmorën veprimet hetimore të sipërpërkshkuara, nuk rezultoi që subjekti kishte në posedim/përdorim apo pronësi ndonjë apartament të ndodhur Gj.L.

---

<sup>51</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2022.

**4. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2019, nga shtetasi V. Q.**

215. Në denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2019, denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa prokurorëve, ndërmjet tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit, për të cilin ka parashtruar se nuk e ka vënë në dijeni lidhur me ecurinë e hetimit.
216. Në një tjetër denoncim të paraqitur disa ditë më vonë, atë me nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2019, denoncuesi ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit, në datën 15.4.2015, ka pushuar në mënyrë të padrejtë çështjen penale nr. \*\*\*, viti 2011, me objekt “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pa autor, duke mos marrë masa ndaj personave të kallëzuar.
217. Komisioni ka analizuar dokumentacionin e administruar dhe ka konstatuar se me vendimin e datës 10.7.2012, të dhënë nga një tjetër prokuror, është vendosur pezullimi i hetimeve paraprake, pasi megjithëse është konstatuar falsifikimi i prokurës dhe akti i shitjes, sikurse është pretenduar edhe nga kallëzuesi, nuk është mundur të identifikohet autori i veprës penale. Hetimi ka rifilluar në datën 15.4.2015, nga prokurori Armand Gurakuqi, i cili, bazuar në nenin 66/c të Kodit Penal, ka vlerësuar se duke qenë se aktet ishin të vitit 2006, afati kohor brenda të cilit duhet të ushtrohej ndjekja penale ishte 5 vjet, për këtë arsye ka vendosur pushimin e hetimit. Vendimin në fjalë, prokurori Armand Gurakuqi ia ka komunikuar shtetasit V. Q. (denoncuesit), me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2015.
218. Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se prokurori ka proceduar në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë institutin e parashkrimit. I ndodhur në kushtet kur kishte kaluar afatet për ndjekje penale (nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur), prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal. Vendimmarrja e tij ka rezultuar e miratuar edhe nga shkallët më të larta të gjyqësorit. Në të tilla kushte konkludohet se nuk prezantohen fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

**5. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2018, nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga shtetasi A. P.**

219. Denoncuesi ka paraqitur 3 denoncime me të njëjtën përmbajtje, në të cilat ka pretenduar parregullsi në hetimin e kallëzimeve të tij nga prokurorët Armand Gurakuqi, S. M. dhe P.F.
220. Komisioni ka konstatuar se kjo çështje është trajtuar edhe në raportin e KLP-së për subjektin e rivlerësimit, si dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila ka arkivuar praktikën, duke njoftuar dhe orientuar ankuesin për t’iu drejtuar gjykatës, si organi kompetent për të vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve të prokurorisë.
221. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar Komisioni ka konstatuar se si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.12.2017, dhe nga ajo e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.2.2018 (e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë), është vlerësuar se kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes duhej pranuar me arsyetimin se pretendimet e denoncuesit nuk ishin objekt i një hetimi penal, por duhet të adresoheshin në rrugë administrative.

222. Në këto kushte vlerësohet se ky denoncim nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni, por duhet të adresohet tek organet përkatëse, sikurse ka konkluduar edhe Prokuroria e Përgjithshme lidhur me ankesën e paraqitur me të njëjtin objekt si denoncimi në fjalë.

**6. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2018, nga shtetasja E. B.**

223. Denoncuesja ka parashtruar se prokurori Armand Gurakuqi ka pushuar në mënyrë të padrejtë procedimin penal nr. \*\*\*, të hetuar fillimisht nga një tjetër prokuror, duke mos marrë në konsideratë sa është konkluduar në një nga aktekspertimet.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

224. Subjekti ka shpjeguar se aktekspertimi teknik i kryer në kuadër të hetimit nuk përmbante të dhëna që ndikonin mbi ligjshmërinë e dhënies së lejes së legalizimit nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2013, objekt hetimi. Përfundimet e paraqitura në kërkesën për pushim të prokurorit ishin bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 141, viti 2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, ‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’, në pikën 11 të VKM-së Nr. 438, datë 28.6.2006, dhe në nenin 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006”.

225. Sipas subjektit, në referencë të normave ligjore dhe nënligjore të mësipërme, procedura e legalizimit zbatohet për objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit, vetëm në rast se për to procedura nuk kërkon kalim pronësie mbi truallin. Në rastin objekt hetimi, ndërtimi për të cilin ishte hartuar leja e legalizimit nuk kërkonte kalim pronësie mbi parcelën ndërtimore, pasi trualli ishte i regjistruar në ZVRPP. Në këto kushte, legalizimi i objektit për të cilin kishte aplikuar denoncuesja dhe familjarët e saj, që konsistonte në shtesa kati dhe jo ndërtim mbi truall, është kryer pa pasur nevojë të ekzistojë lidhja e ndërtimit me pronësinë e truallit.

**Vlerësimi i trupit gjykues**

226. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi analizoi dokumentacionin e administruar lidhur me këtë denoncim, konkludoi se nuk u konstatuan shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij lidhur me këtë çështje dhe se pretendimet e denoncuesit jo vetëm që gjenden të bazuara në fakte, por ato i referohen mënyrës së vlerësimit të provave nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me të cilën Komisioni nuk mund të vlerësojë, pasi del jashtë tagrave të tij.

**7. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2018, nga shtetasja F. B.**

227. Denoncuesja ka pretenduar se prokurori ka pushuar në mënyrë të padrejtë kallëzimin e bërë prej saj ndaj punonjësit të ZVRPP-së Tiranë dhe ATP-së dhe është treguar i njëanshëm, duke mos hetuar mbi kthimin e pronës nga ATP-ja, shtetasit I. H.

228. Komisioni i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me kërkesën e denoncueses datë 15.11.2000, për regjistrimin e pasurisë me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.7.2001, ka regjistruar pasurinë shtëpi banimi me sipërfaqe 89 m<sup>2</sup> dhe truall me sipërfaqe 550 m<sup>2</sup>, të përfutur sipas

kontratës së shitblerjes datë 19.6.1990, nr. \*\*\*, nga shtetasja N. C., ndërkohë që kjo e fundit nuk ka qenë pronare e truallit, por vetëm e banesës.

229. Referuar vendimit të pushimit të datës 6.4.2009, objekt denoncimi, ka rezultuar se fillimisht është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit. Këtij procedimi penal i është bashkuar kallëzimi penal i shtetases F. B. në datën 3.4.2008.
230. Nga ana e prokurorit, pasi janë kryer një sërë veprimesh hetimore, ndër të tjera, pyetja e kufitarëve të pronës, marrja e dëshmimeve nga punonjësit e ZRPP-së, sekuestrimi i dokumentacionit pranë ZVRPP-së, këqyrja e dokumenteve pranë zyrës së noteres ku është përpiluar kontrata e shitjes së pronës në fjalë, është konkluduar se shitja është kryer në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës së vitit 1976, shfuqizuar me ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, ku parashikohej se *prona shtetërore i përket popullit...*
231. Ky fakt është pranuar edhe nga vetë noterja, e cila ka deklaruar se në periudhën e përpilimit të kontratës së sipërcituar nuk ka qenë i lejuar tjetërsimi i oborreve dhe i trojeve dhe se paraqitja e oborrit si objekt i kontratës së shitjes përbënte një gabim të kryer prej saj.
232. Në analizë të sa më sipër, prokurori ka konkluduar se shtetasja Sh. K. ishte përgjegjëse për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal të vitit 1977, sipas të cilit kjo vepër dënohej me 10 vjet burg.
233. Referuar nenit 66, germa “b” e Kodit Penal, kjo vepër është parashkruar pasi kanë kaluar 10 vjet nga kryerja e saj. Në të tilla kushte konkludohet se nuk prezantohen fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

#### **8. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019, nga shtetasi S. T.**

234. Denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa prokurorëve, ndërmjet tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit. Në denoncim ai ka përshkruar një kronologji të gjatë të historikut të familjes së tij lidhur me të drejta pronësie dhe trashëgimtarët e këtyre të drejtave ndër vite.
235. Nga shqyrtimi i denoncimit nuk ka rezultuar i përshkruar ndonjë fakt apo shkelje procedurale që i atribuohet prokurorit Armand Gurakuqi dhe as nuk është paraqitur ndonjë provë kundër tij që do të ngarkonte prokurorin me përgjegjësi disiplinore.
236. Denoncimi në fjalë është marrë disa herë në shqyrtim nga Komisioni edhe për subjekte të tjera rivlerësimi dhe, në përfundim, nuk janë vërejtur *indicie* për thellimin e hetimeve.

#### **9. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2018, nga shtetasi K. K.**

237. Denoncuesi ka pretenduar se në lidhje me kallëzimin penal të tij, datë 20.9.2016, prokurori Armand Gurakuqi ka vendosur pushimin e çështjes, duke mos kryer verifikime dhe pa kërkuar sqarime.
238. Nga shqyrtimi i vendimit objekt denoncimi, Komisioni ka konstatuar se me vendimin e datës 29.5.2014, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me paligjshmërinë e procedurës së dhënies së lejes zhvillimore nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2013, të kryetarit të Komunës K., është vendosur më parë mosfillimi i procedimit.



239. Prokurori Armand Gurakuqi, me vendimin e pushimit datë 20.9.2016, pasi ka kryer veprimet procedurale të nevojshme, ka konkluduar se rrethanat e pretenduara prej tij nuk parashikoheshin nga ligji si vepër penale dhe se bazuar në nenin 291 të Kodit Penal nuk mund të regjistrohet një procedim, për një fakt për të cilin ishte vendosur mosfillimi.
240. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.11.2016, ka vendosur *rrëzimin e kërkesës ankimore* ndaj vendimit të prokurorit Armand Gurakuqi.
241. Ndonëse denoncuesi e ka ankimuar vendimin e gjykatës, të cituar më sipër, Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2018, e ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke arsyetuar, ndër të tjera, se: *“Vendimi i mosfillimit i datës 20.9.2016, është i drejtë e i bazuar në prova e në ligj. Prokurori ka kryer veprime të plota hetimore verifikuese dhe në përputhje me ligjin procedural penal e atë material”*.
242. Përveç faktit që vendimi i prokurorit Armand Gurakuqi është miratuar dhe lënë në fuqi edhe nga të dyja shkallët e gjyqësorit, Komisioni, duke parë zgjidhjen e kësaj çështjeje nën dritën e objektivitetit dhe proporcionalitetit, gërshetuar edhe me bindjen e brendshme të prezantuar nga subjekti, me të cilën ka ndërmarrë veprimet hetimore në kontekstin e vlerësimit si një çështje që duhet të ndiqet nga shërbimi përmbartimor, arrin në përfundimin se nuk reflektohen shkaqe apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

#### **10. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2018, nga shtetasi B. B.**

243. Denoncuesi ka parashtruar se prokurori Armand Gurakuqi ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e tij për veprat penale si: vjedhja e energjisë; dëmtimi i rrugës; dhe ushtrimi i aktivitetit pa licencë për një qendër për larjen e automjeteve, e vendosur mbi pronën e babait të tij. Ai është shprehur se prokurori Armand Gurakuqi është bazuar në shkresat dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet përkatëse, por nuk ka kryer verifikimin në vend.
244. Nisur nga fakti se denoncuesi nuk ka paraqitur prova apo dokumente në mbështetje të pretendimeve të tij, si dhe nuk ka evidentuar shkelje procedurale konkrete, Komisioni është përpjekur ta kontaktojë atë, por kjo gjë nuk u bë e mundur<sup>52</sup>. Në këto kushte është vlerësuar se denoncimi nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të merret në konsideratë.

#### **11. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2019, nga shtetasi H. R.**

245. Shtetasi H. R. ka depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në KLP ndaj Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, një funksionari publik, si dhe ndaj subjektit të rivlerësimit, duke vënë në dijeni edhe Komisionin.
246. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasi H. R., me vendimin e datës 5.5.2010, prokurori Armand Gurakuqi ka

<sup>52</sup> Zyra e Denoncimeve ka tentuar ta kontaktojë denoncuesin, për plotësimin e denoncimit me provat e nevojshme, në numrin e telefonit të vënë në dispozicion prej tij, por ky nr., ka rezultuar jashtë funksionit.

vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, duke e orientuar kallëzuesin t'i drejtohej gjykatës administrative për pretendimet e tij.

247. Komisioni ka konstatuar se në këtë denoncim nuk referohen shkelje konkrete në drejtim të aftësive profesionale të subjektit Armand Gurakuqi apo ndonjë provë për korrupsion nga ana e tij, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e denoncuesit lidheshin me vendimmarrjen, për të cilën, në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se nuk është në kompetencën e Komisionit gjykimi mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes.

### **12. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2019, nga shtetasi A. D.**

248. Denoncuesi ka ngritur pretendime për disa subjekte rivlerësimi, si dhe ndaj prokurorit Armand Gurakuqi, duke pretenduar se vendimi nr. \*\*\*, datë regjistrimi 30.1.2018, i dhënë prej tij ishte i padrejtë dhe i njëanshëm.

249. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se prokurori Armand Gurakuqi ka ngritur akuzën në ngarkim të të pandehurit A. D., për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, akuzë e cila ka rezultuar e pranuar nga denoncuesi edhe gjatë kohës kur është marrë në pyetje nga prokuroria në cilësinë e të pandehurit. Në përfundim, prokurori ka kërkuar dënimin e tij, sipas nenit 291 të Kodit Penal.

250. Vendimmarrja e prokurorit është ligjëruar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 510, 23.2.2018, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit A. D., për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 muaj burgim.

251. Për sa më sipër, Komisioni, bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, ka konstatuar se shqyrtimi i pretendimeve të denoncuesit (nëse vendimi ka qenë i drejtë ose jo) del jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit. Megjithatë, sikurse ka rezultuar nga aktet e administruara, gjykata, pasi e ka shqyrtuar këtë çështje, si organi kompetent për këtë vlerësim, e ka gjetur të drejtë vendimmarrjen e prokurorit Armand Gurakuqi, ndërsa, në aspektin procedural duket se nuk janë konstatuar shkelje, hetime të paplota apo arsyetim i dobët nga ana e subjektit të rivlerësimit.

### **13. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2019, nga shtetasi M. L.**

252. Denoncuesi ka përmendur disa prokurorë, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit, por ndaj këtij të fundit nuk ka përshkruar ndonjë fakt apo shkelje procedurale dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë, që do të ngarkonte prokurorin Armand Gurakuqi me përgjegjësi disiplinore.

253. Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se denoncimi nuk përmbush kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim.

#### **14. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2021, nga shtetasi S. S.**

254. Denoncuesi ka pretenduar se procedimi penal nr. \*\*\* është pushuar në mënyrë të padrejtë nga prokurori Armand Gurakuqi.
255. Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>53</sup> kërkesën penale të datës 12.3.2021. Nga shqyrtimi i saj ka rezultuar se prokurori Armand Gurakuqi, në përfundim të hetimit, ka konstatuar mungesën e elementeve të veprës penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ndërsa, lidhur me pretendimin e kallëzuesit për bashkëpronësi mbi objektin e legalizuar, prokurori ka parashtruar se ky pretendim duhet të referohet për zgjidhje pranë organeve kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me natyrë civile.
256. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>54</sup>, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2022, ka vlerësuar se hetimet nuk kanë qenë të plota dhe të gjithanshme dhe, për rrjedhojë, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 12.3.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme. Ky vendim është ankimuar nga prokurori Armand Gurakuqi, por siç ka komunikuar Gjykata e Apelit Tiranë, ka bërë me dije<sup>55</sup> se deri në datën 5.12.2022 çështja nuk është planifikuar për gjykim.
257. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar, ndër të tjera, se pretendimet e kallëzuesit janë marrë në shqyrtim nga prokurori. Prokurori ka urdhëruar kryerjen e hetimeve (dokumentuar kjo me urdhrat përkatës), por nga ana e policisë gjyqësore nuk janë zbatuar të gjitha veprimet e kërkuara, sikurse është administrimi i dokumentacionit nga ASHK-ja, i cili është kërkuar, por ky institucion ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumenteve. Për rrjedhojë, gjykata ka vlerësuar kthimin e akteve për hetime të mëtejshme.
258. Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar lidhur me denoncimin në fjalë, Komisioni ka konstatuar se prokurori Armand Gurakuqi ka kryer veprimet hetimore të vlerësuara prej tij si të nevojshme në funksion të çështjes objekt hetimi. Kryerja e këtyre veprimeve hetimore është në tagrin e tij si prokuror, mbi bazën e vlerësimit të provave të administruara së bashku me kallëzimin.
259. Në këto kushte, Komisioni, bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, ka konstatuar se shqyrtimi i pretendimeve të denoncuesit del jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit.

#### **LIDHUR ME DISA FAKTE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA**

260. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me artikuj të publikuar në disa media *online*, nga analizimi i të cilave janë konstatuar disa artikuj si vijojnë:

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

<sup>54</sup> Administruar vendimi me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>55</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2022.

## 1. Në lidhje me një denoncim në R.al<sup>56</sup>

261. Nga denoncimi ka rezultuar se Arkidioqeza Tiranë-Durrës dhe B. E. J. kanë denoncuar prokurorin Armand Gurakuqi me pretendimin se *ka nxjerrë përfundime të pabazuara në ligj e në prova, në tejkalim të kompetencave të tij ka zhvilluar hetime penale, megjithëse ekzistonin të gjitha rrethanat që nuk lejonin fillimin dhe vazhdimin e procedimit penal*, lidhur me pronën e Kishës Katolike, për të cilën ka pasur pretendime nga dy familje. Kjo çështje është trajtuar në procese gjyqësore civile e penale dhe gjykatat e të tria shkallëve në të dy juridiksionet kanë vendosur në favor të Kishës Katolike.
262. Nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit nga Prokuroria<sup>57</sup> dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>58</sup> ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2016, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit K. A., i cili ka pretenduar të drejta pronësie mbi sipërfaqen e pronës që i është njohur Kishës.
263. Prokurori Armand Gurakuqi, në përfundim të hetimeve, në datën 12.6.2018, ka vendosur *pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, pa autor, të veprave penale ‘mashttrim’ dhe ‘falsifikim’, parashikuar nga nenet 143/1 dhe 186 të Kodit Penal*, me argumentin se nuk është konsumuar vepra penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ndërsa, për veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, duke qenë se kanë kaluar më shumë se 20 vjet, ka kërkuar pushimin e ndjekjes penale në bazë të nenit 66 të Kodit Penal, për shkak të parashkrimit.
264. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.10.2018, ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë dhe urdhërimin e saj për vazhdimin e hetimeve, për shkak se aktekspertimi nuk ka qenë i plotë<sup>59</sup>.
265. Më pas, çështja është hetuar nga një tjetër prokurore, e cila, me kërkesën e datës 22.5.2019, pas përmbushjes së detyrave të caktuara nga gjykata, ka kërkuar në gjykatë pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, pa autor, të veprave penale “mashttrim” dhe “falsifikim”, parashikuar nga nenet 143/1 dhe 186 të Kodit Penal, me argumentin se nuk provohet se është konsumuar vepra penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në formën e përdorimit të dokumenteve në institucione të ndryshme. Kjo vepër konsumohet nëpërmjet prodhimit apo përdorimit me dashje të një dokumenti të falsifikuar. Për sa i përket hartimit të dokumentit nga persona që e kanë pasur për detyrë, prokurori ka vlerësuar se gjendet në kushtet e parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të Kodit Penal. Ndërsa, për veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, duke qenë se kanë kaluar më shumë se 20 vjet, ka kërkuar pushimin e ndjekjes penale në bazë të nenit 66 të Kodit Penal, për shkak të parashkrimit.

<sup>56</sup> [https://www.r\\*\\*\\*.al/2019/02/14/kisha-katolike-dennoncon-prokurorin-armand-gurakuqi/](https://www.r***.al/2019/02/14/kisha-katolike-dennoncon-prokurorin-armand-gurakuqi/)

<sup>57</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

<sup>58</sup> Nga dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2022.

<sup>59</sup> Në konkluzionet përfundimtare të aktit, ekspertja teknike është shprehur se: “KKKP-ja ka marrë 3 vendime për një pronë që ndodhet në të njëjtën zonë kadastrale, ndërkohë që prona duhet të trajtohet në një vendim”. Për të dhënë një ekspertizë më të plotë, ekspertes i nevojitej dokumentacioni teknik për secilën pronë që prej origjinës së saj.

266. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.7.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016.
267. Për sa më sipër, ndonëse janë kryer veprimet hetimore shtesë të kërkuara nga gjykata, edhe prokurori tjetër që ka hetuar çështjen objekt denoncimi, në përfundim, ka arritur në të njëjtin konkluzion me atë të arritur nga subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi.
268. Për sa më sipër, duket se nuk janë konstatuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti. Komisioni, bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, ka konstatuar se pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara.

## 2. Në lidhje me artikullin e publikuar në median *Sh.com*<sup>60</sup>

269. Në median *online sh.com* ka rezultuar i publikuar artikulli me përmbajtjen si vijon:
270. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *Kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 6.11.2018, për veprën penale 'shpërdorim detyre', parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*
271. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar<sup>61</sup> se me vendimin penal nr. \*\*\* akti, datë 15.7.2020, prokurori Armand Gurakuqi ka kërkuar pushimin e procedimit nr. \*\*\*, datë 6.11.2018, me arsyetimin se nga ana e punonjësve të SHISH-it nuk janë konsumuar elementet e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
272. Në vijim, gjykata ka çmuar se prokuroria duhet të kryente hetimet plotësuese si vijon: 1. *Të administrohen dëshmitë e dhëna nga punonjësit e SHISH dhe nga prokurori B. H. gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në ngarkim të të pandehurit A. V. 2. Të ripyeten oficerët e SHISH A. T. dhe A. D., si dhe prokurori B. H. lidhur me këtë fakt dhe në rast kontradiktash të kryhet ballafaqimi midis tyre. 3. T'i kërkohet informacion SHISH-it dhe Prokurorisë që administron dosjen nëse u vu në dispozicion pajisja e përgjimit për llogari të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016 dhe a u krye ndonjë veprim hetimor përgjimi, pa cenuar sekretin hetimor. Të pyeten lidhur me këtë fakt dhe për dijeninë e tyre lidhur me kërkesën për pajisje përgjimi prokurorët e tjerë të grupit hetimor që heton procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2016. 4. Të kryejë çdo veprim tjetër hetimor të nevojshëm në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm.*
273. Ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., (D/P), datë 24.12.2018, ka konfirmuar se shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2018, drejtuar SHISH-it, është administruar tek aktet e hetimeve paraprake për procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2016. Nga aktet e këtij procedimi nuk ka rezultuar asnjë e

<sup>60</sup>[https://sh\\*\\*\\*.com/lajm/dosja-babalegjykata-kthen-per-plotesim-te-hetimeve-ceshtjen-kerkohet-ballafaqimi-i-\\*\\*\\*-me-dy-agjentet-e-shish](https://sh***.com/lajm/dosja-babalegjykata-kthen-per-plotesim-te-hetimeve-ceshtjen-kerkohet-ballafaqimi-i-***-me-dy-agjentet-e-shish)

<sup>61</sup> Në vijim të kërkesës me nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2022, me email-in e datës 11.10.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është dërguar informacion lidhur me vendimin penal nr. \*\*\* akti, datë 15.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur kthimin e akteve për hetim.

dhënë nëse pajisja e kërkuar iu dha prokurorisë nga SHISH-i dhe çfarë veprimesh përgjimi u kryen me të në kuadër të procedimit nr. \*\*\*.

274. Komisioni ka administruar<sup>62</sup> kërkesën për pushim datë 6.11.2018 të prokurorit, si dhe ankimin datë 6.11.2018 në apel.

275. Nga Gjykata e Apelit<sup>63</sup> është bërë me dije se lidhur me çështjen në fjalë nuk është përcaktuar ende një datë për gjykim.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

276. Subjekti ka shpjeguar se procedimi penal nr. \*\*\*, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nuk ishte i lidhur me procedurën e përgjimit të kryer nga SHISH-i mbi bazën e informacioneve të dhëna nga shtetasi A. V. Për këtë arsye ishte e panevojshme kryerja e veprimeve të ngarkuara nga gjykata lidhur me atë procedim. Një nga detyrat e ngarkuara nga kjo e fundit ishte: “T’i kërkohet informacion SHISH-it dhe prokurorisë, që administrojnë dosjen, nëse u vu në dispozicion pajisja e përgjimit për llogari të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, dhe a u krye ndonjë veprim hetimor përgjimi, pa cenuar sekretin hetimor. Të pyeten lidhur me këtë fakt dhe për dijeninë e tyre lidhur me kërkesën për pajisje përgjimi prokurorët e tjerë të grupi hetimor që heton procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2016”. Këto veprime hetimore nuk janë të lidhura me çështjen penale nr. \*\*\*, e cila ka pasur si objekt hetimet mbi ligjshmërinë e përgjimeve operative të kryera nga SHISH-i mbi bazën e informacionit të dhënë nga shtetasi A. V. Vendosja ose jo nga SHISH-i në dispozicion të Prokurorisë për Krimet e Rënda të pajisjes së përgjimit të kërkuar për llogari të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, është një rrethanë që nuk ka asnjë ndikim në procedurën e përgjimit për informacionin e shtetasit A. V. Për këto arsye, sipas subjektit, detyrat e mësipërme të caktuara nga gjykata ishin tërësisht të panevojshme.

277. Subjekti ka cilësuar gjithashtu të panevojshëm administrimin e dëshmimeve nga punonjësit e SHISH-it dhe nga prokurori B. H. pasi, sipas tij, z. H. i kishte dhënë shpjegimet e tij edhe në kuadër të hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*. Deklarimet që ai kishte dhënë si pjesë e kësaj çështjeje penale ishin mëse të mjaftueshme për të konfirmuar fillimin e procedurës së përgjimit nga SHISH-i. Nga këto shpjegime provohet se përgjimet janë zhvilluar pasi shtetasi A. V. ka dhënë informacion tek z. H. dhe ky i fundit, ka mundësuar takimin e z. V. me punonjësit e shërbimit.

278. Të njëjtat rrethana janë konfirmuar nga punonjësit e shërbimit informativ R. T., A. D. dhe E. M. dhe rezultojnë edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2018, e SHISH-it. Në këto kushte rezulton e provuar se këta persona dhe z. H. janë pyetur lidhur me objektin e hetimit të çështjes nr. \*\*\*.

279. Është e rëndësishme të nënvizohet që në aktet e dosjes nr. \*\*\* nuk përmbahet asnjë akt apo e dhënë, nga të cilat të rezultojë se shtetasi B. H. dhe punonjësit e SHISH-it kanë dhënë apo jo dëshmi në gjykimin në ngarkim të të pandehurit A. V. Për këto arsye, kjo detyrë

<sup>62</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

<sup>63</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2022.

është caktuar nga gjykata në mungesë të të dhënave të nevojshme mbi ekzistencën e këtyre dëshmive.

280. Gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës për pushim duke caktuar edhe detyrën: “Të ripyeten oficerët e SHISH-it A. T. dhe A. D., si dhe prokurori B. H. lidhur me këtë fakt dhe në rast kontradiktash të kryhet ballafaqimi midis tyre”. Në kushtet kur këta persona janë pyetur në kuadër të hetimit dhe kanë dhënë shpjegimet e tyre, të cilat janë konfirmuar edhe nga provat shkresore të administruara, ripyetja e tyre, sipas subjektit, do të ishte një procedurë tërësisht e panevojshme. Ripyetja e personave gjatë hetimit mund të kryhet vetëm në rastet kur pas deklarimit të dhënë më parë kanë rezultuar të dhëna të tjera që e bëjnë të nevojshme rithirrjen e deklaruesit. Gjatë hetimit, por edhe gjatë seancës për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, nuk ka rezultuar asnjë nevojë e tillë.

281. Bazuar në rrethanat e mësipërme, nga prokurori është ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës për mospranimin e kërkesës për pushimin e çështjes, duke e cilësuar vendimin e saj si të pabazuar në ligj dhe në prova.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

282. Komisioni, nisur nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, çmon se ato janë bindëse dhe vlerësohen të mjaftueshme në vetvete për të përjashtuar mangësi profesionale nga ana e tij.

#### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

283. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore dhe serioze në lidhje me drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e tij, shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

284. Trupi gjykues vlerëson se bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi:

- a. Në lidhje me kriterin e pasurisë ka kryer deklarime të pamjaftueshme si dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e germës “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në

vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

- b. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve apo hetime të paplota apo të pakryera nga subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi, vlerëson se ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.
- d. Gjithashtu, çmon se në një vlerësim të përgjithshëm dhe tërësor të dinamikës, rrethanave, deklaratimeve, shpjegimeve dhe dokumenteve të administruara në lidhje me marrëdhëniet juridiko-financiare të krijuara nga personi i lidhur (bashkëshortja) me z. Sh. dhe me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., përpos investimeve në mënyrë të përsëritur, duke përdorur mjete monetare të huazuara në një masë shumë më të madhe sesa ato të disponuara nga vetë subjekti, vërehen një sërë faktesh që, të ndërthurura mes tyre, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, për rrjedhojë, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në datën 28.4.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*